



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernora Governor's Office	
E Dërguar: Predalo: Send to:	DPPP
Data: Datum: Date:	29.12.2023
Nr: Br: No:	501-D-23

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/ 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -150 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 03 prill 2017), nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11/11 maj 2012), neni 4 paragrafi 3 dhe neni 129 paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L- 045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.38/24 dhjetor 2015) neni 23 paragrafi 6 si dhe nenin 66 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.18/15 qershor 2016), Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2023, miratoi këtë:

**UDHËZUES PËR KUJDESIN E DUHUR TË KLIENTIT DHE FAKTORËT QË  
BANKAT DHE INSTITUCIONET FINANCIARE DUHET TË MARRIN PARASYSH  
GJATË VLERËSIMIT TË RREZIKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE  
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT**

**Neni 1**

**Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të përcaktojë faktorët që institucionet financiare duhet ti marrin parasysh kur vlerësojnë rrezikun nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit si dhe nivelin e zbatimit të masave të kujdesit të duhur ndaj klientit në përpjesëtim me rrezikun e PP/FT të identifikuar.
2. Faktorët e rrezikut të përcaktuar me këtë Udhëzues nuk duhet të konsiderohen si shterues prandaj institucionet financiare sipas nevojës marrin parasysh edhe faktorë tjerë gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit parave dhe financimit të terrorizmit.

## Neni 2

### Fushëveprimi

Ky Udhëzues është përgatitur në bashkëpunim dhe koordinim me Njësinë për Inteligjencë Financiare (NJIF-K), si dhe zbatohet për të gjitha bankat, institucionet financiare jobankare, institucionet mikrofinanciare, siguruesit dhe zyrat e këmbimit të valutave.

## Neni 3

### Përkufizimet

1. Të gjitha termet në këtë udhëzues kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara në Rregulloren për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e këtij udhëzimi.
2. *Institucion Financiar* – nënkupton bankat, institucionet financiare jo bankare, institucionet mikrofinanciare, siguruesit, fondet pensionale dhe zyra të këmbimit valuator
3. *PP/FT* – Pastrimi i Parave dhe Financimi i Terrorizmit
4. *Rrezik* - nënkupton ndikimin dhe gjasat e PP/FT që të ndodhë. Rreziku i referohet rrezikut të qenësishëm, domethënë nivelit të rrezikut që ekziston përpara zbatimit të masave zbutëse. Nuk i referohet rrezikut të mbetur, domethënë nivelit të rrezikut që mbetet pas zbutjes.
5. *Rrezik inherent* – nënkupton rrezikun e qenësishëm që ekziston përpara zbutjes.
6. *Faktorët e Rrezikut* – nënkupton variabla që më vete ose të kombinuara mund të rrisin ose zvogëlojnë rrezikun e PP/FT.
7. *KDK* – Kujdesi i duhur ndaj klientit
8. *KDSH* – Kujdesi i duhur i shtuar
9. *KDTH* – Kujdesi i duhur i thjeshtëzuar
10. *PEP* – Person i ekspozuar politikisht

## Neni 4

### Vlerësimi i rrezikut të PP/FT

1. Institucionet financiare duhet të sigurohen që kanë njohuri të plota të rreziqeve nga PP/FT ndaj të cilave janë të ekspozuara.
2. Institucionet financiare duhet të vlerësojnë rrezikun nga PP/FT ndaj të cilit janë të ekspozuar si rezultat i natyrës dhe kompleksitetit të veprimtarisë së institucionit dhe vlerësimin e rrezikut



nga PP/FT ndaj të cilit janë të ekspozuar si rezultat i hyrjes në marrëdhënie biznesore dhe realizimit të transaksioneve të rastit.

3. Vlerësimi i rrezikut nga PP/FT duhet të përbëhet nga dy hapa të veçantë por të ndërlidhur:
  - 3.1 Identifikimi i faktorëve të rrezikut nga PP/FT
  - 3.2 Vlerësimi i rrezikut të PP/FT
4. Kur vlerësohet niveli i përgjithshëm i rrezikut të mbetur të PP/FT, institucionet financiare duhet të marrin parasysh nivelin e rrezikut inherent dhe cilësinë e kontrolleve dhe faktorëve të tjerë zbutës të rrezikut.

## **Neni 5**

### **Përditësimi i vlerësimit të rrezikut nga PP/FT**

1. Institucionet financiare duhet të vendosin sisteme dhe kontrolle për të siguruar që vlerësimet e tyre për rrezikun nga PP/FT mbeten të përditësuara dhe relevante.
2. Sistemet dhe kontrollet për të siguruar që vlerësimet e rrezikut për PP/FT mbeten të përditësuara dhe relevante përfshijnë:
  - 2.1. Përcaktimi i një date për çdo vit kalendarik në të cilin realizohet përditësimi i ardhshëm i vlerësimit të rrezikut për PP/FT në nivel të veprimtarisë së institucionit dhe në nivel të marrëdhënieve biznesore dhe transaksioneve të rastit.
  - 2.2. Reflektimi i menjëhershëm në vlerësimet e tyre të rrezikut për PP/FT kur identifikohet se një rrezik i ri nga PP/FT është shfaqur ose një rrezik ekzistues është rritur.
  - 2.3. Regjistrimi i kujdesshëm i të gjitha çështjeve apo ngjarjeve relevante përgjatë periudhës përkatëse që mund të kenë ndikim në vlerësimin e rrezikut nga PP/FT.
3. Institucionet financiare duhet gjithashtu të sigurojnë që kanë sisteme dhe kontrolle të vendosura për të identifikuar rreziqet e reja nga PP/FT, ti vlerësojnë këto rreziqe, dhe kur është e përshtatshme, në kohën e duhur ti inkorporojnë ato në vlerësimin e rrezikut të PP/FT.

## **Neni 6**

### **Vlerësimi i rrezikut PP/FT në nivel të veprimtarisë së institucionit**

1. Vlerësimi i rrezikut në nivel të veprimtarisë duhet të ndihmojë institucionet financiare të kuptojnë se ku janë të ekspozuara ndaj rrezikut të PP/FT-së dhe cilat fusha të biznesit të tyre duhet ti japin prioritet në luftën kundër PP/FT-së.
2. Institucionet financiare duhet të kenë pamje të plotë të rreziqeve të PP/FT ndaj të cilave janë të ekspozuara, duke identifikuar dhe vlerësuar rrezikun e PP/FT lidhur me produktet dhe

shërbimet që ofrojnë, juridiksionet në të cilat shtrijnë veprimtarinë e tyre dhe kanalet e distribuimit që përdorin për ti shërbyer klientët.

3. Institucionet financiare duhet të sigurojnë që vlerësimi i rrezikut në nivel të veprimtarisë së tyre të jetë në përputhje me profilin e biznesit të tyre dhe njëkohësisht duhet të merren parasysh faktorët dhe rreziqet specifike për biznesin e institucionit.
4. Në rastet kur institucioni financiar është pjesë e grupit që harton vlerësimin e rrezikut në të gjithë grupin, institucioni financiar duhet të marrë parasysh nëse vlerësimi i rrezikut në kuadër të grupit është mjaftueshëm specifik për të pasqyruar biznesin e institucionit dhe rreziqet ndaj të cilit janë të ekspozuar si rezultat i lidhjeve të grupit me vendet dhe zonat gjeografike, dhe nëse është e nevojshme plotësojnë vlerësimin e rrezikut në kuadër të grupit. Nëse grupi është i vendosur në ndonjë vend i cili është i lidhur me nivel të lartë të korrupsionit, institucioni financiar duhet të pasqyrojë këtë fakt në vlerësimin e rrezikut edhe nëse vlerësimi i rrezikut në kuadër të grupit nuk e pasqyron këtë pikë.
5. Një vlerësim i përgjithshëm i rrezikut nga PP/FT i cili nuk është i përshtatur me nevojat specifike dhe modelin e biznesit të institucionit ose një vlerësim i rrezikut në nivel të grupit që zbatohet pa diskutim, nuk mund të konsiderohet që plotëson kriteret rregullative dhe ligjore në fuqi.
6. Informacioni që përmban ky udhëzues synon të ofrojë një orientim të përgjithshëm për rreziqet dhe menaxhimin e tyre dhe nuk zëvendëson masat ligjore të parashikuara në Ligjin për PPP/LFT dhe rregulloret përkatëse në fuqi.
7. Hapat që duhet të ndërmarrin institucionet financiare në identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të PP/FT duhet të jenë në proporcion me natyrën dhe madhësinë e institucionit. Institucionet e vogla të cilat nuk ofrojnë produkte ose shërbime komplekse dhe që kanë ekspozim të kufizuar apo vetëm vendor, mund të mos kenë nevojë për një vlerësim kompleks ose të sofistikuar të rrezikut.
8. Institucioni financiar duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të siguruar që i gjithë stafi të kuptojë vlerësimin e rrezikut të PP/FT dhe ndikimin e tij në punën e tyre.
9. Institucioni financiar duhet të informojë dhe të ju sigurojë informacion të mjaftueshëm menaxhmentit të lartë në lidhje me rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe mbi nivelin e rrezikut të ekspozuar.

## Neni 7

### **Vlerësimi i rrezikut nga PP/FT në nivel të marrëdhënieve biznesore**

1. Institucionet financiare duhet të identifikojnë se ndaj cilave rreziqe të PP/FT janë ose ekspozohen si rezultat i hyrjes ose mbajtjes së një marrëdhënie biznesore ose realizimit të një transaksioni të rastit.



2. Institucionet financiare gjatë identifikimit të rrezikut nga PP/FT që lidhen me marrëdhëniet biznesore apo transaksionet e rastit, duhet të konsiderojnë faktorët përkatës të rrezikut duke përfshirë se kush është klienti i tyre, vendet apo zonat gjeografike ku operojnë, produktet, shërbimet dhe transaksionet që kërkon klienti si dhe kanalet e distribuimit për këto produkte, shërbime dhe transaksione.
3. Institucionet financiare para se të hyjnë në marrëdhënie biznesi apo të realizojnë transaksione të rastit, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullative në fuqi, duhet të aplikojnë masat e kujdesit të duhur ndaj klientit të cilat të paktën përfshijnë:
  - 3.1 Identifikimin e klientit dhe në rastet kur kërkohet pronarin përfitues;
  - 3.2 Verifikimin e klientit në bazë të burimeve të besueshme dhe të pavarura dhe, aty ku është e zbatueshme të verifikojë identitetin e pronarit përfitues;
  - 3.3 Përcaktimi i qëllimit dhe natyrës së marrëdhënies biznesore.
4. Institucionet financiare duhet të rregullojnë nivelin e zbatimit të masave fillestare të kujdesit të duhur ndaj klientit të bazuar në rrezik duke marrë parasysh gjetjet nga vlerësimi i rrezikut në mbarë biznesin. Në rastet kur rreziku lidhur me një marrëdhënie biznesi ka të ngjarë të jetë i ulët, institucionet mund të zbatojnë masa të thjeshtëzuara të kujdesit ndaj klientit. Ndërsa në rastet kur rreziku lidhur me një marrëdhënie biznesi ka të ngjarë të rritet, institucionet duhet të aplikojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar.
5. Institucionet financiare duhet të mbledhin informacion të mjaftueshëm në mënyrë që të identifikojnë të gjithë faktorët përkatës të rrezikut në fillim apo gjatë marrëdhënies së biznesit apo para realizimit të transaksioneve të rastit.

## **Neni 8**

### **Identifikimi i faktorëve të rrezikut të PP/FT**

1. Institucionet financiare duhet të identifikojnë faktorët e rrezikut që lidhen me klientët e tyre, vendet ose zonat gjeografike, produktet dhe shërbimet dhe kanalet e distribuimit.
2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij neni, institucionet financiare duhet të marrin parasysh dhe jo të kufizohen, në burimet e të dhënave si më poshtë:
  - 2.1. Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare të rrezikut të PP/LT;
  - 2.2. Ligjet, Rregulloret, Udhëzimet si dhe dokumentet tjera relevante të lëshuara nga autoritetet kompetente në vend;
  - 2.3. Raportet dhe informacionet tjera të publikuara nga Njësia për Inteligjencë Financiare dhe autoritetet tjera qeveritare kompetente për ndjeke penale;
  - 2.4. Informacioni i marrë nga kujdesi i duhur i klientit/ve;
  - 2.5. Njohuritë dhe përvojën profesionale;

*S.*

## Neni 9

### Faktorët e rrezikut të PP/FT lidhur me klientin dhe pronarin përfitues

1. Faktorët e rrezikut që mund të konsiderohen relevant gjatë identifikimi të rrezikut lidhur me aktivitetin apo veprimtarinë e klientit dhe pronarit përfitues, përfshijnë duke mos u kufizuar në:
  - 1.1. A ka klienti ose pronari përfitues lidhje me sektorë që zakonisht ndërlidhen me rrezik më të lartë të korrupsionit?
  - 1.2. A ka klienti ose pronari përfitues lidhje me sektorë që janë të lidhur me rrezikshmëri më të lartë të PP/FT?
  - 1.3. A ka klienti ose pronari përfitues lidhje me sektorë që përfshijnë sasi të konsiderueshme të parave në të gatshme?
  - 1.4. Kur klienti është një person juridik, trust, apo lloj tjetër marrëveshjeje ligjore, cili është qëllimi i krijimit të tyre? Për shembull, cila është natyra e biznesit të tyre?
  - 1.5. A ka klienti lidhje politike, për shembull, a janë persona të ekspozuar politikisht (PEP), apo a është pronari përfitues një PEP ? Kur një klient ose pronari përfitues është PEP, subjekti duhet të zbatojnë masa të kujdesit të duhur të shtuar në përputhje me nenin 22 të Ligjit për PPP/LFT?
  - 1.6. A mban klienti ose pronari përfitues pozitë tjetër të shquar apo gëzon reputacion të lartë publik që mund t'i lejojë të abuzojë me këtë pozitë për përfitime private?
  - 1.7. A është klienti person juridik që i nënshtrohet rregullave dhe kërkesave të zbatueshme të publikimit që sigurojnë që informacioni i besueshëm në lidhje me pronarin përfitues të klientit është në dispozicion publik, për shembull kompanitë publike të listuara në bursat që e bëjnë një deklaram të tillë kusht për tu listuar?
  - 1.8. A është klienti bankë apo institucion financiar që vepron në llogarinë e vet nga një juridiksion me regjim efektiv të PPP/LFT dhe a mbikëqyret në nivel vendor për respektimin e detyrimeve të PPP/LFT? A ka prova që klienti i është nënshtruar sanksioneve mbikëqyrëse ose ndëshkimit për mosrespektim të detyrimeve të PPP/LFT ose kërkesave tjera të administrimit më të gjerë në vitet e fundit?
  - 1.9. A është klienti institucion publik ose ndërmarrje nga një juridiksion me nivele të ulët të korrupsionit?
  - 1.10. A është njohuria për klientin ose pronarin përfitues në përputhje me atë që subjekti raportues di për veprimtarinë e tyre të mëparshme, aktuale ose të planifikuar të biznesit, qarkullimin e biznesit të tyre, burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së pronarit përfitues?



2. Faktorët e rrezikut që mund të konsiderohen relevant gjatë identifikimit të rrezikut lidhur me reputacionin e klientit dhe pronarit përfitues, përfshijnë duke mos u kufizuar në:
  - 2.1. A ka raporte kundërtënëse të mediave ose burime të tjera të rëndësishme të informacionit në lidhje me klientin, për shembull a ka ndonjë pretendim të kriminalitetit ose terrorizmit ndaj klientit ose pronarit përfitues? Nëse po, a janë këto të mbështetura dhe të besueshme? Subjektet raportuese duhet të përcaktojnë besueshmërinë e pretendimeve në bazë të cilësisë dhe pavarësisë së burimit të të dhënave dhe këmbënguljes së raportimit të këtyre pretendimeve, ndër konsiderata të tjera. Subjektet raportuese duhet të kenë vëmendje që vetëm mungesa e dënimeve penale mund të mos jetë e mjaftueshme për të hedhur poshtë pretendimet për keqbërje.
  - 2.2. A ka njohuri se klienti, pronari përfitues ose dikush tjetër që është i lidhur ngushtë me ta, ka fonde apo pasuri tjera të ngrira për shkak të procedurave administrative ose penale ose pretendimeve për terrorizëm ose financim të terrorizmit? A ka subjekti raportues arsye për të dyshuar se klienti ose pronari përfitues ose dikush tjetër i njohur publikisht se është i lidhur ngushtë me ta, në një moment të së kaluarës i është nënshtruar ngrirjes së tillë të fondeve apo pasurisë?
  - 2.3. A e di subjekti raportues nëse klienti ose pronari përfitues ka qenë subjekt i raportit të transaksioneve të dyshimta në të kaluarën?
  - 2.4. A ka subjekti raportues ndonjë informacion të brendshëm në lidhje me integritetin e klientit ose pronarit përfitues, të marrë, për shembull, gjatë një marrëdhënie biznesi të gjatë?
3. Faktorët e mëposhtëm të rrezikut mund të jenë të rëndësishëm kur merret parasysh rreziku lidhur me natyrën dhe sjelljen e klientit ose pronarit përfitues; institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë faktin që jo të gjithë këta faktorë rreziku janë të dukshëm që në fillim; këta faktorë mund të shfaqen vetëm pasi të jetë krijuar marrëdhënia e biznesit:
  - 3.1. A ka klienti arsye të ligjshme që ia bënë të pamundurën të sigurojë prova të forta bindëse të identitetit të tij ?
  - 3.2. A ka subjekt raportues dyshime për vërtetësinë apo saktësinë e identitetit të klientit ose pronarit përfitues?
  - 3.3. A ka indikacione që klienti bënë përpjekje të shmangë krijimin e marrëdhënies së biznesit? Për shembull, a kërkon klienti të kryejë një transaksion ose disa transaksione të njëanshme kur në situata të tilla krijimi i një marrëdhënie biznesi mund të ketë më shumë kuptim ekonomik?
  - 3.4. A është pronësia e klientit dhe struktura e kontrollit transparente dhe a ka kuptim? Nëse pronësia dhe struktura e kontrollit të klientit është komplekse ose e errët, a ekziston arsyetim i dukshëm tregtar ose ligjorë?



- 3.5. A lëshon klienti aksione bartëse apo ka aksionarë të nominuar.
- 3.6. A është klienti një person juridik ose marrëveshje juridike që mund të përdoret si mbajtës i fondeve apo pasurisë?
- 3.7. A ekziston arsye bindëse për ndryshime në strukturën e pronësisë dhe kontrollit të klientit?
- 3.8. A kërkon klienti transaksione që janë të natyrës komplekse, të pashpjeguara, jashtëzakonisht të mëdha ose ka një model të pazakontë ose të papritur pa një qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor ose arsyetim të shëndoshë tregtar? A ka arsye për të dyshuar se klienti po përpiket të shmangë pragjet specifike siç janë ato të përcaktuara në Ligjin për PPP/LFT, kur është e aplikueshme?
- 3.9. A kërkon klienti nivele të panevojshme ose të paarsyeshme të fshehtësisë? Për shembull, a është klienti i gatshëm të shpërndajë informacionin e KDK, apo duket se dëshiron të maskojë natyrën e vërtetë të biznesit të tij?
- 3.10. A mund të shpjegohet me lehtësi burimi i pasurisë dhe fondeve të klientit ose pronarit përfitues, për shembull përmes punësimit, trashëgimisë ose investimeve? A është shpjegimi i arsyeshëm?
- 3.11. A i përdor klienti produktet dhe shërbimet të cilat i ka marrë ashtu siç pritej kur u krijua marrëdhënia e biznesit?
- 3.12. Kur klienti është jorezident, a ekziston një arsyetim i shëndoshë ekonomik dhe i ligjshëm për klientin që kërkon llojin e tillë të shërbimit financiar?
4. Kur identifikohet rreziku që lidhet me natyrën dhe sjelljen e një klienti ose pronari përfitues, institucionet financiare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë faktorëve të rrezikut që, megjithëse nuk janë specifike për financimin e terrorizmit, mund të tregojnë për rritjen e rrezikut të TF, veçanërisht në situatat kur faktorë të tjerë të rrezikut TF janë gjithashtu prezentë. Për këtë qëllim, institucionet financiare duhet të marrin parasysh të paktën faktorët e mëposhtëm të rrezikut:
- 4.1. A është klienti ose pronari përfitues një person i përfshirë në listat e personave, grupeve dhe subjekteve të përfshirë në akte terroriste dhe subjekt i masave kufizuese, apo dihet se kanë lidhje të ngushta personale ose profesionale me personat e regjistruar në lista të tilla (për shembull, sepse janë në një lidhje apo ndryshe jetojnë me një person të tillë)?
- 4.2. A është klienti ose pronari përfitues një person që dihet publikisht se është nën hetim për veprimtari terroriste ose është dënuar për veprimtari terroriste, apo dihet se kanë lidhje të ngushta personale ose profesionale me një person të tillë?
- 4.3. A kryen klienti transaksione që karakterizohen nga transferata fondesh hyrëse dhe dalëse nga dhe/ose drejt vendeve ku dihet se veprojnë grupet që kryejnë vepra terroriste, që dihet se janë burime të financimit të terrorizmit ose që janë subjekt i



sanksioneve ndërkombëtare? Nëse po, a mund të shpjegohen lehtësisht këto transferime, për shembull, nëpërmjet lidhjeve familjare ose marrëdhënies tregtare?

- 4.4. A është klienti organizatë jofitimprurëse, aktivitetet ose menaxhmenti i së cilës publikisht është i lidhur me ekstremizëm apo simpatitë terroriste; sjellja e transaksioneve të të cilit karakterizohet nga transferime të mëdha të shumave të mëdha të fondeve në juridiksione të lidhura me rreziqe më të larta të PP/TF dhe vende të treta me rrezik të lartë?
- 4.5. A kryen klienti transaksione të karakterizuara nga flukse të mëdha parash në një periudhë të shkurtër kohore, duke përfshirë organizata jofitimprurëse me lidhje të paqarta (p.sh. ata janë të vendosur në të njëjtin vendndodhje fizike; ata ndajnë të njëjtët përfaqësues ose punonjës ose mbajnë llogari të shumta me të njëjtët emra)?

## Neni 10

### Faktorët e rrezikut të PP/FT lidhur me vendet dhe zonat gjeografike

1. Gjatë identifikimit të faktorëve të rrezikut lidhur me vendet dhe zonat gjeografike, institucionet financiare duhet të marrin parasysh rrezikun që lidhet me:
  - 1.1. Juridiksionet në të cilat klienti dhe pronari përfitues është i vendosur apo është rezident;
  - 1.2. Juridiksionet të cilat janë vendet e operimit të klientëve dhe pronarëve përfitues; dhe
  - 1.3. Juridiksionet në të cilat klienti dhe pronari përfitues kanë lidhje përkatëse personale, biznesore, financiare apo interesa ligjor.
2. Institucionet financiare duhet të kenë parasysh se natyra dhe qëllimi i marrëdhënies së biznesit, ose lloji i biznesit, shpesh përcakton rëndësinë relative të vendit individual dhe faktorëve gjeografikë të rrezikut. Për shembull:
  - 2.1. Kur fondet e përdorura në marrëdhëniet e biznesit janë gjeneruar jashtë vendit, niveli i veprave penale të ndërlidhura me pastrimin e parave dhe efektiviteti i sistemit juridik të vendit janë veçanërisht të rëndësishme.
  - 2.2. Kur fondet merren, ose dërgohen në juridiksione, ku dihet se veprojnë grupe që kryejnë vepra terroriste, institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë deri në çfarë mase kjo mund të pritet ose mund të krijojë dyshime, bazuar në atë që institucioni financiar di për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit.
  - 2.3. Kur klienti është bankë ose institucion financiar, subjektet raportuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë regjimit të duhur të PPP/LFT të vendit dhe efektivitetit të mbikëqyrjes për PPP/LFT.

- 2.4. Kur klienti është person juridik ose trust, institucionet financiare duhet të marrin parasysh shkallën në të cilën vendi ku klienti dhe, kur është e aplikueshme, pronari përfitues janë regjistruar, përmbushë në mënyrë efektive standardet ndërkombëtare të transparencës tatimore.
3. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë efektivitetin e regjimit të PPP/LFT të një juridiksioni përfshijnë:
- 3.1. A është identifikuar vendi me mangësi strategjike në regjimin e tij për PPP/LFT?
  - 3.2. A e ndalon legjislacioni i vendit implementimin e politikave dhe procedurave në nivel të grupit?
  - 3.3. A ka informacione nga më shumë se një burim i besueshëm dhe kredibil në lidhje me cilësinë e kontrollit të PPP/LFT të juridiksionit, përfshirë informacione në lidhje me cilësinë dhe efektivitetin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit rregullator? Shembuj të burimeve të mundshme përfshijnë raportet e vlerësimit të ndërsjellë nga Task Forca për Veprimin Financiar (FATF) ose organet rajonale të stilit FATF (FSRB) (një pikënisje e mirë është përmbledhja ekzekutive dhe gjetjet kryesore dhe vlerësimi i pajtueshmërisë me Rekomandimet 10, 26 dhe 27 dhe Rezultatet e Menjëhershme 3 dhe 4), lista e FATF me rrezikshmëri të lartë dhe vendet jo bashkëpunuese, vlerësimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Vlerësimit të Programit të Sektorit Financiar (FSAP). Institucionet financiare duhet të kenë parasysh që anëtarësimi në FATF ose FSRB (p.sh. Moneyval) nuk nënkupton se regjimi për PPP/LFT i juridiksionit është adekuat dhe efektiv.
4. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë nivelin e rrezikut të financimit të terrorizmit të lidhur me një juridiksion përfshijnë:
- 4.1. A ka informacione, për shembull nga autoritetet e zbatimit të ligjit ose burime të besueshme dhe të kredibile të mediave të hapura, që sugjerojnë që një juridiksion siguron fonde ose mbështetje për aktivitete terroriste ose që grupet që kryejnë vepra terroriste dihet se operojnë në atë vend ose territor?
  - 4.2. A është juridiksioni subjekt i sanksioneve financiare, embargove ose masave që kanë të bëjnë me terrorizmin, financimin e terrorizmit ose përhapjen e proliferimit, për shembull, nga Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian?
5. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë nivelin e transparencës dhe pajtueshmërisë së juridiksionit në fushën e tatimeve përfshijnë:
- 5.1. A ka informacione nga më shumë se një burim i besueshëm dhe kredibil se vendi është konsideruar në përputhje me transparencën në fushën e tatimeve ndërkombëtare dhe standardet e shkëmbimit të informacionit? A ka prova që rregullat përkatëse zbatohen në mënyrë efektive në praktikë? Shembuj të burimeve të mundshme përfshijnë raporte nga Forumi Global për Transparencën dhe Shkëmbimin e Informacionit për qëllimet



tatimore të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), të cilat vlerësojnë juridiksione për transparencën e taksave dhe qëllimet e shkëmbimit të informacionit; vlerësimet e komiteteve të juridiksioneve për shkëmbim automatik të informacionit bazuar në Standardin e Përbashkët të Raportimit; vlerësimet e pajtueshmërisë me rekomandimet e FATF 9, 24 dhe 25 dhe rezultatet e menjëhershme 2 dhe 5 nga FATF ose FSRB; dhe vlerësimet e FMN (p.sh. vlerësimet e stafit të FMN-së për qendrat financiare që operojnë në vendet offshore).

- 5.2. A është zotuar juridiksioni dhe a ka zbatuar në mënyrë efektive, Standardin e Përbashkët të Raportimit për Shkëmbim Automatik të Informacionit, i cili është miratuar nga G20 në vitin 2014?
  - 5.3. A ka krijuar juridiksioni regjistra të besueshëm dhe të qasshëm të pronësisë përfutuese?
6. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë rrezikun që lidhet me nivelin e veprave penale të predikimit për pastrim parash përfshijnë:
- 6.1. A ka informacione nga burime kredibile dhe të besueshme publike në lidhje me nivelin e veprave penale të ndërlidhura për pastrimin e parave, për shembull korrupsioni, krimi i organizuar, veprat penale tatimore dhe mashtrimi? Shembuj përfshijnë indekset e perceptimit të korrupsionit; Raportet e vendit të OECD për zbatimin e konventës së OECD kundër ryshfetit; dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin - Raporti i Drogës Botërore.
  - 6.2. A ka informacion nga më shumë se një burim i besueshëm dhe kredibil në lidhje me aftësinë e sistemit hetimor dhe gjyqësor të juridiksionit për të hetuar dhe ndjekur penalisht në mënyrë efektive këto vepra penale?

## Neni 11

### **Faktorët e rrezikut të PP/FT lidhur me produktet, shërbimet dhe transaksionet**

1. Gjatë identifikimit të faktorëve të rrezikut lidhur me produktet, shërbimet dhe transaksionet, institucionet financiare duhet të marrin parasysh rrezikun që lidhet me:
  - 1.1. nivelin e transparencës së produktit, shërbimit ose transaksionit që mund të ofrohet;
  - 1.2. kompleksitetin e produktit, shërbimit ose transaksionit; dhe
  - 1.3. vlerën ose madhësinë e produktit, shërbimit ose transaksionit.
2. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë rrezikun që lidhet me transparencën e një produkti, shërbimi ose transaksioni përfshijnë:
  - 2.1. Në çfarë mase produktet ose shërbimet lejojnë klientin, pronarin përfutues ose strukturat e pronësisë përfutuese të mbeten anonime, ose të lehtësojnë fshehjen e identitetit të tyre?

Shembuj të produkteve dhe shërbimeve të tilla përfshijnë aksione bartëse, depozita në mirëbesim, subjektet juridike në vendet offshore, trustet të caktuara, dhe subjektet juridike si fondacione që mund të strukturohen në atë mënyrë që të përfitojnë nga anonimiteti dhe të lejojnë marrëdhënie me kompani guaskë (shell) ose kompani me aksionarë të emëruar.

- 2.2. Në çfarë mase është e mundur që një palë e tretë që nuk është pjesë e marrëdhënies së biznesit të japë udhëzime, për shembull në rastin e marrëdhënieve të caktuara korrespondente bankare?
3. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë rrezikun që lidhet me kompleksitetin e një produkti, shërbimi ose transaksioni përfshijnë:
  - 3.1. Sa është kompleks transaksioni dhe a përfshin palë të shumta ose juridiksione të shumta, për shembull në rastin e transaksioneve të caktuara tregtare afariste?
  - 3.2. Në ç'masë produktet ose shërbimet lejojnë pagesa nga palët e treta ose pranojnë mbi-pagesa aty ku normalisht nuk pritej? Aty ku pritet pagesa e palëve të treta, a e njëj institucioni financiar identitetin e palës së tretë, për shembull a është një autoritet shtetëror përfitues apo një garantues? Apo a janë produktet dhe shërbimet të financuara ekskluzivisht nga transferimet e fondeve nga llogaria e vetë klientit në një institucion tjetër financiar që i nënshtrohet standardeve dhe mbikëqyrjes për PPP/LFT ?
  - 3.3. A i kupton institucioni financiar rreziqet që lidhen me produktin ose shërbimin e saj të ri ose inovativ, veçanërisht kur kjo përfshin përdorimin e teknologjive ose metodave të reja të pagesës ?
4. Faktorët e rrezikut që institucionet financiare duhet të marrin parasysh kur identifikojnë rrezikun lidhur me vlerën ose madhësinë e një produkti, shërbimi ose transaksioni përfshijnë:
  - 4.1. Në ç'masë produktet ose shërbimet mbështesin përdorimin e parave në të gatshme, siç janë shumë shërbime pagesash por edhe llogari të caktuara rrjedhëse ?
  - 4.2. Në ç'masë produktet ose shërbimet inkurajojnë ose lehtësojnë transaksionet me vlera të larta? A ka ndonjë kufizim mbi vlerat e transaksionit ose nivelet e primit që mund të kufizojnë përdorimin e produktit ose shërbimit për qëllime të PP/FT ?

## Neni 12

### Faktorët e rrezikut të PP/FT lidhur me kanalet e shpërndarjes

1. Gjatë identifikimit të faktorëve të rrezikut lidhur me kanalet e shpërndarjes, institucionet financiare duhet të marrin parasysh rrezikun që lidhet me:
  - 1.1. shkallën në të cilën marrëdhënia e biznesit realizohet pa prezencë fizike;
  - 1.2. aplikimin e palëve të treta apo ndërmjetësuesve.



2. Kur vlerësohet rreziku që lidhet me mënyrën në të cilën klienti merr produktet ose shërbimet, institucionet financiare duhet të marrin parasysh një sërë faktorësh duke përfshirë:
  - 2.1. Nëse klienti është i pranishëm fizikisht për qëllime të identifikimit. Nëse jo, a ka aplikuar institucioni financiar formë të besueshme të KDK-së pa prezencë fizike? A janë ndërmarrë hapa për të parandaluar falsifikimin apo mashtrimin e identitetit.
  - 2.2. Nëse klienti është identifikuar nga palë të treta, faktorët që duhet të merren parasysh janë:
    - 2.2.1. Nëse pala e tretë aplikon masat e KDK-së, ruan dhe mban të dhënat sipas kërkesave ligjore në fuqi, mbikëqyret për pajtueshmërinë me PPP/LFT si dhe nëse ka indikacione për palën e tretë që niveli i pajtueshmërisë me PPP/LFT është jo adekuat apo nëse ka qenë subjekt i masave administrative për shkelje të obligimeve për PPP/LFT.
    - 2.2.2. Nëse pala e tretë vjen nga juridiksione me rrezik të lartë të PP/FT.
    - 2.2.3. Institucionet financiare duhet të sigurohen nëse pala e tretë siguron me kohë sipas kërkesës dokumentet e identifikimit apo verifikimit; kualiteti i masave të KDK-së është i pranueshëm; niveli i KDK-së së aplikuar nga pala e tretë është në përputhje me rrezikun nga PP/FT.
  - 2.3. Nëse klienti është identifikuar nëpërmjet një agjenti të lidhur, pra pa kontakt të drejtpërdrejtë të institucionit financiar, në çfarë mase institucioni financiar mund të jetë i kënaqur që agjenti ka marrë informacion të mjaftueshëm për të siguruar që institucioni financiar e njeh klientin e saj dhe nivelin e rrezikut të lidhur me marrëdhëniet e biznesit.

### **Neni 13**

#### **Vlerësimi i rrezikut të PP/FT**

1. Institucionet financiare duhet të kenë një pamje tërësore të faktorëve të rrezikut të PP/FT që ata kanë identifikuar, të cilët së bashku përcaktojnë nivelin e rrezikut të PP/FT lidhur me një marrëdhënie biznesi, një transaksion të rastësishëm ose biznesin e tyre.
2. Institucionet financiare kur vlerësojnë rrezikun nga PP/FT, mund të peshojnë faktorët varësisht nga rëndësia e tyre relative.
3. Kur vlerësohen faktorët e rrezikut, duhet të bëhet një vlerësim i informuar në lidhje me rëndësinë e faktorëve të ndryshëm të rrezikut në kontekstin e marrëdhënies së biznesit ose transaksionit të rastit.

4. Rëndësia e dhënë secilit prej faktorëve ka të ngjarë të ndryshojë nga produkti në produkt dhe nga klienti tek klienti (ose kategoria e klientit) si dhe nga një institucion në tjetrin. Kur vlerësohen faktorët e rrezikut, institucionet financiare duhet të sigurojnë që:
  - 4.1.Vlerësimi nuk duhet të ndikohet padrejtësisht vetëm nga një faktor;
  - 4.2.Vlerësimet ekonomike ose fitimi nuk ndikojnë në vlerësimin e rrezikut;
  - 4.3.Vlerësimi nuk çon në një situatë kur është e pamundur që çfarëdo marrëdhënie biznesi të klasifikohet si rrezik i lartë;
  - 4.4.Dispozitat ligjore në lidhje me situatat që gjithmonë paraqesin një rrezik të lartë të pastrimit të parave nuk mund të mbivendosen nga vlerësimet e institucionet financiar.
5. Kur institucioni financiar përdor sisteme të automatizuara të TI-së për të ndarë rezultatet e përgjithshme të rrezikut për të kategorizuar marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet e rastit dhe nuk i zhvillon ato vetë por i blen nga një ofrues i jashtëm, duhet të kuptojë se si funksionon sistemi dhe si kombinohen faktorët e rrezikut për të arritur rezultatin e përgjithshëm të rrezikut. Institucioni financiar duhet të jetë gjithmonë në gjendje të bindë veten se rezultatet e fituara reflektojnë të kuptuarit për rrezikun për PP/FT dhe duhet të jetë në gjendje ta demonstrojë këtë tek autoriteti kompetent.

#### **Neni 14**

##### **Kategorizimi i rrezikut**

1. Institucionet financiare duhet të vendosin për mënyrën më të përshtatshme për të kategorizuar rrezikun. Kjo varet nga natyra dhe madhësia e biznesit dhe nga llojet e rrezikut të PP/FT ndaj të cilit është e ekspozuar. Megjithëse institucionet shpesh e kategorizojnë rrezikun si të lartë, të mesëm dhe të ulët, kategorizimet e tjera janë të mundshme.
2. Pas vlerësimit të rrezikut, dhe duke marrë parasysh si rreziqet e qenësishme ashtu edhe masat zbutëse që ka identifikuar, institucioni duhet të kategorizojë linjat e saj të biznesit, si dhe marrëdhëniet e tyre të biznesit dhe transaksionet e rastësishme sipas nivelit të perceptuar të rrezikut të PP/TF.

#### **Neni 15**

##### **Masat e Kujdesit Duhur ndaj klientit të zbatueshme për të gjitha institucionet financiare**

1. Vlerësimet e rrezikut duhet të ndihmojnë institucionin financiar që të identifikojë se ku duhet të përqendrojë përpjekjet për menaxhimin e rrezikut të PP/FT, si në pranimin e klientëve ashtu edhe gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënies së biznesit.
2. Institucionet financiare duhet të sigurojnë që politikat dhe procedurat e tyre për PPP/LFT bazohen dhe reflektojnë vlerësimin e tyre të rrezikut.



3. Institucionet financiare gjithashtu duhet të sigurojnë që politikat dhe procedurat e tyre për PPP/LFT të jenë lehtësisht të disponueshme, të aplikuara, efektive dhe të kuptueshme nga i gjithë stafi përkatës.
4. Kur përmbushin detyrimin e tyre për të marrë miratimin për politikat, kontrollet dhe procedurat e tyre për PPP/LFT nga menaxhmenti i lartë, institucionet financiare duhet të sigurojnë që menaxhmenti i lartë të ketë qasje në të dhëna të mjaftueshme, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut nga PP/FT, në mënyrë që të jenë të informuar mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e këtyre politikave dhe procedurave dhe në veçanti për masat e KDK-së.

## **Neni 16**

### **Kujdesi Duhur ndaj Klientit**

1. Masat e kujdesit duhur duhet të ndihmojnë institucionet financiare që të kuptojnë më mirë rrezikun që lidhet me marrëdhëniet individuale të biznesit dhe transaksionet e rastit.
2. Si pjesë e kësaj, institucionet financiare duhet të zbatojnë secilën nga masat për KDK të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për PPP/LFT, por mund të përcaktojnë shtrirjen e këtyre masave edhe mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut.
3. Institucionet financiare duhet të përcaktojnë qartë, në politikat dhe procedurat e tyre.
  - 3.1. Kush është klienti dhe, sipas rastit, pronari përfitues për çdo lloj klienti dhe kategori produktesh dhe shërbimesh, dhe identiteti i të cilit duhet të verifikohet për qëllime të KDK-së.
  - 3.2. Çfarë përbën një transaksion të rastit në kontekstin e biznesit të tyre dhe në cilin moment një seri transaksionesh të njëhershme përbën një marrëdhënie biznesi, në vend të një transaksioni të rastësishëm, duke marrë parasysh faktorë të tillë si frekuenca ose rregullsia me të cilën klienti kthehet për transaksionet e rastësishme dhe masën në të cilën lidhja pritët të ketë, ose duket të ketë, një element kohëzgjatjeje. Institucionet financiare duhet të kenë parasysh se kufiri monetar i përcaktuar sipas dispozitave ligjore në fuqi është i rëndësishëm vetëm në masën që shkakton një kërkesë absolute për të zbatuar masat e KDK-së; një sërë transaksionesh të rastësishme mund të jenë një marrëdhënie biznesi edhe kur ky prag nuk arrihet;
  - 3.3. Si verifikohet identiteti i klientit dhe, aty ku është e zbatueshme, pronarit përfitues dhe si presin që të krijohet natyra dhe qëllimi i marrëdhënies së biznesit;
  - 3.4. Cili nivel monitorimi zbatohet në çfarë rrethanash;
  - 3.5. Apetiti i rrezikut të institucionit financiar.
4. Institucionet financiare duhet të jenë në gjendje t'i demonstrojnë autoritetit të tyre mbikëqyrës se masat e KDK-së që ata kanë aplikuar janë në përputhje me rreziqet e PP/FT.

## Neni 17

### Kujdesit Duhur i Thjeshtësuar ndaj Klientit

1. Në masën e lejuar nga legjislacioni vendorë, institucionet financiare mund të zbatojnë masa të kujdesit të duhur të thjeshtësuar në situata kur rreziku i PP/FT i lidhur me marrëdhënie biznesi është vlerësuar si i ulët. Kujdesi i duhur i thjeshtësuar nuk është një përjashtim nga ndonjë prej masave të KDK-së; sidoqoftë, institucionet financiare mund të rregullojnë volumin, kohën ose llojin e secilës ose të gjitha masave të KDK në mënyrën që është në përputhje me rrezikun e ulët që ata kanë identifikuar.
2. Masat e kujdesit të duhur të thjeshtësuar ndaj klientit që institucionet financiare mund të aplikojnë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
  - 2.1. Përshtatja e kohës së KDK-së, për shembull kur produkti ose transaksioni i kërkuar ka veçori që kufizojnë përdorimin e tij për qëllime PP/FT, për shembull nga:
    - 2.1.1. verifikimin e identitetit të klientit ose pronarit përfitues gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit; ose
    - 2.1.2. verifikimi i identitetit të klientit ose pronarit përfitues pasi transaksionet kalojnë një prag të përcaktuar ose pasi të ketë kaluar një afat i arsyeshëm kohor (siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi). Institucionet financiare duhet të sigurohen që:
      - 2.1.2.1. kjo nuk rezulton në një përjashtim de facto nga KDK, domethënë, institucionet financiare duhet të sigurojnë që identiteti i klientit ose pronarit përfitues verifikohet përfundimisht;
      - 2.1.2.2. pragu ose afati kohor është vendosur në nivel të ulët të arsyeshëm (megjithëse, në lidhje me financimin e terrorizmit, institucionet financiare duhet të kenë në konsideratë se pragu i ulët si i vetëm mund të mos jetë i mjaftueshëm për të zvogëluar rrezikun);
      - 2.1.2.3. të kenë sisteme për të zbuluar kur është arritur pragu ose afati kohor; dhe
      - 2.1.2.4. nuk e lënë anash KDK ose nuk vonojnë marrjen e informacionit përkatës në lidhje me klientin, kur legjislacioni në fuqi kërkon që ky informacion të merret në fillim.
    - 2.1.3. Përshtatja e sasisë së informacionit të marrë për qëllime identifikimi, verifikimi ose monitorimi, për shembull nga:



- 2.1.3.1.verifikimi i identitetit në bazë të informacionit të marrë nga një dokument kredibil, i besueshëm dhe i pavarur ose vetëm nga burimi i të dhënave; ose
  - 2.1.3.2. duke pretenduar natyrën dhe qëllimin e marrëdhënies së biznesit sepse produkti është krijuar vetëm për një përdorim të veçantë, siç është skema e pensionit të kompanisë ose kartelat për dhurata në qendrat tregtare.
  - 2.1.4. Përshtatja e cilësisë ose burimit të informacionit të marrë për qëllime identifikimi, verifikimi ose monitorimi, për shembull nga:
    - 2.1.4.1. dhënia përparësi informacionit të marrë nga klienti përpara sesa nga një burim i pavarur kur verifikoni identitetin e pronarit përfitues; ose
    - 2.1.4.2. ku rreziku i lidhur me të gjitha aspektet e marrëdhënies është shumë i ulët, duke u mbështetur në burimin e fondeve për të përmbushur disa nga kërkesat e KDK, për shembull kur fondet janë pagesa të përfitimit nga shteti ose ku fondet janë transferuar nga një llogari në emër të klientin nga subjekti raportues nga Zona Ekonomike Evropiane.
  - 2.1.5. Përshtatja e shpeshtësisë dhe intensitetit të monitorimit të transaksioneve, për shembull duke monitoruar transaksionet vetëm mbi një prag të caktuar. Kur institucionet financiare zgjedhin ta bëjnë këtë, ata duhet të sigurojnë që pragu është vendosur në një nivel të arsyeshëm dhe që ata kanë sisteme në vend për të identifikuar transaksionet e lidhura, të cilat, së bashku, tejkalojnë atë prag.
3. Informacioni që institucioni financiar merr kur aplikon masat e KDTh-së duhet t'i mundësojë institucionit financiar që të jetë i kënaqur në mënyrë të arsyeshme që vlerësimi i saj se rreziku lidhur me marrëdhënien është i ulët dhe është i arsyetuar. Duhet gjithashtu të jetë i mjaftueshëm për t'i dhënë institucionit financiar informacion të mjaftueshëm për natyrën e marrëdhënies së biznesit për të identifikuar ndonjë transaksion të pazakontë ose të dyshimtë. Aplikimi i kujdesit të duhur të thjeshtëzuar nuk e përjashton një institucion financiar nga raportimi i transaksioneve të dyshimta në NJIF-K.

## Neni 18

### Kujdesi Duhur i Shtuar ndaj Klientit

1. Institucionet financiare duhet të zbatojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar në situata me rrezik më të lartë për të menaxhuar dhe zbutur ato rreziqe në mënyrë të përshtatshme. Masat e kujdesit

të duhur të shtuar nuk mund të zëvendësohen me masat e rregullta të KDK-së, por duhet të zbatohen krahas masave të rregullta të KDK-së.

2. Rastet specifike të cilat institucionet financiare duhet ti trajtojnë gjithmonë me rrezik të lartë mund të përfshijnë:
  - 2.1. kur klienti, ose pronari përfitues i klientit, është PEP;
  - 2.2. kur institucioni financiar ka të bëjë me persona fizikë ose subjekte juridike të vendosur në vendet e treta me rrezik të lartë;
  - 2.3. sa i përket marrëdhënieve korrespondente me bankat respondente nga vendet e treta;
  - 2.4. të gjitha transaksionet të cilat janë:
    - 2.4.1. komplekse;
    - 2.4.2. jashtëzakonisht të mëdha;
    - 2.4.3. realizuar në formë të pazakontë ose:
    - 2.4.4. që nuk kanë ndonjë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor.
3. Institucionet financiare duhet të zbatojnë masa e KDSH në ato situata kur kjo është proporcionale me rrezikun e PP/FT që ata kanë identifikuar.

## **Neni 19**

### **Udhëzime specifike sipas sektorit**

1. Udhëzimet specifike për sektorët, plotësojnë udhëzimet e përgjithshme të këtij udhëzuesi. Subjektet raportuese duhet të kenë një vështrim të përgjithshëm të rrezikut lidhur me situatën dhe të kenë në konsideratë se faktorët e izoluar të rrezikut jo domosdoshmërisht vendosin një marrëdhënie biznesi ose transaksion të rastit në një kategori rreziku më të lartë ose më të ulët.

## **Neni 20**

### **Udhëzime për bankat komerciale**

1. Institucionet bankare duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
  - 1.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 1.1.1. tiparet e produktit që favorizojnë anonimitetin;



- 1.1.2. produkti lejon pagesa nga palë të treta që nuk janë të ndërlidhur me produktin ose nuk identifikohen paraprakisht, kur pagesa të tilla nuk janë të pritshme, për shembull për hipoteka ose kredi;
  - 1.1.3. produkti nuk vendos kufizime në qarkullim, transaksione ndërkufitare ose veçori të ngjashme të produktit;
  - 1.1.4. produkte të reja dhe praktika të reja biznesi, duke përfshirë mekanizmat e rinj të shpërndarjes, dhe përdorimin e teknologjive të reja ose në zhvillim për produkte të reja dhe ekzistuese, kur këto ende nuk janë kuptuar mirë;
  - 1.1.5. huadhënia (përfshirë hipotekat) e siguruar kundrejt vlerës së pasurive në juridiksione të tjera, veçanërisht vendeve ku është e vështirë të konstatohet nëse klienti ka titull të ligjshëm për kolateralin, ose ku identiteti i palëve që garantojnë kredinë është vështirë të verifikohet;
  - 1.1.6. vëllim jashtëzakonisht i lartë ose vlerë e madhe e transaksioneve.
- 1.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
- 1.2.1. Produkti ka tipare të kufizuar, për shembull në rastet si në vijim:
    - 1.2.1.1. produkt kursimi me afat të caktuar me pragje të ulëta të kursimeve;
    - 1.2.1.2. produkt ku përfitimet nuk mund të realizohen për përfitimin e një pale të tretë;
    - 1.2.1.3. produkt ku përfitimet realizohen vetëm në planin afatgjatë ose për një qëllim specifik, siç është pensioni ose blerja e pasurisë;
    - 1.2.1.4. kredie me vlerë të ulët, përfshirë atë që kushtëzohet nga blerja e një malli ose shërbimi specifik të konsumit; ose
    - 1.2.1.5. produkt me vlerë të ulët, duke përfshirë qira, ku titulli ligjor dhe përfitues i fondeve nuk i transferohet klientit derisa marrëdhënia kontraktuale të përfundojë ose asnjëherë nuk mund të bartet.
  - 1.2.2. Produkti mund të mbahet vetëm nga kategori të caktuara klientësh, për shembull pensionistë, prindër në emër të fëmijëve të tyre, ose të mitur deri sa të mbushin moshën madhore.
  - 1.2.3. Transaksionet duhet të kryhen përmes llogarisë në emrin e klientit në bankë ose institucion financiar që i nënshtrohet kërkesave të PPP/LFT sipas standardeve ndërkombëtare.
  - 1.2.4. Nuk ofrohen lehtësira për mbipagesë.
- 1.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti:
- 1.3.1. Natyra e klientit, për shembull:

- 1.3.1.1. Klienti qarkullon me para në të gatshme
  - 1.3.1.2. Klienti është subjekt që ndërlidhet me nivel më të lartë të rrezikut të pastrimit të parave, për shembull, bizneset e lojërave të fatit.
  - 1.3.1.3. Klienti është subjekt i ndërlidhur me rrezik më të lartë korrupsioni, për shembull operon në industritë e nxjerrjes së mineraleve ose tregtinë e armëve.
  - 1.3.1.4. Klienti është organizatë jofitimprurëse që mbështet juridiksione të ndërlidhura me rrezik të lartë të FT.
  - 1.3.1.5. Klienti është kompani e re pa një portfolio të duhur biznesi ose të dhëna nga e kaluara.
  - 1.3.1.6. Klienti është jo rezident.
  - 1.3.1.7. Pronari përfitues i klientit nuk mund të identifikohet lehtë, për shembull, sepse struktura e pronësisë së klientit është e pazakontë, panevojshëm e ndërlikuar ose e errët.
- 1.3.2. Sjellja e klientit, për shembull:
- 1.3.2.1. Klienti nuk ka dëshirë të paraqitet ose sigurojë informacione për KDK me qëllim për të shmangur kontaktin ballë për ballë.
  - 1.3.2.2. Të dhënat e identitetit të klientit janë në formë jo standarde pa ndonjë arsye të dukshme.
  - 1.3.2.3. Sjellja e klientit ose vëllimi i transaksionit nuk është në përputhje me atë që pritet nga kategoria e klientit të cilës ata i përkasin, ose është e papritur bazuar në informacionin që klienti ka dhënë në hapjen e llogarisë.
  - 1.3.2.4. Sjellja e klientit është e pazakontë, për shembull klienti papritur dhe pa sqarim të arsyeshëm përshpejton kohën e rënë dakord të ripagimit, me anë të ripagimit të një shume ose përfundimit të parakohshëm; depozita ose pagesa dalëse në banknota me vlerë të lartë pa arsye të dukshme; rrit aktivitetin pas një periudhe të fjetur; ose bën transaksione që duket se nuk kanë asnjë arsyetim ekonomik.
- 1.4. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga klienti:
- 1.4.1. Konsumatori është klient prej shumë kohësh, transaksionet e mëparshme të të cilit nuk kanë paraqitur dyshime ose shqetësime, dhe produkti ose shërbimi i kërkuar është në përputhje me profilin e rrezikut të klientit.
- 1.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendi ose rrezikut gjeografik.
- 1.5.1. Fondet e klientit vijnë nga biznesi ose lidhje personale në juridiksione të lidhura me rrezik më të lartë të PP/FT.



- 1.5.2. Paguesi është i vendosur në juridiksion të ndërlidhur me rrezik më të lartë të PP/FT. Subjektet raportuese duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve të njohura për sigurimin e fondeve ose mbështetjes për aktivitete terroriste ose kur grupet që kryejnë vepra terroriste dihet se operojnë, dhe juridiksionet janë subjekt i sanksioneve financiare, embargove ose masave që kanë të bëjnë me terrorizmin, financimin e terrorizmit ose përhapjen.
- 1.6. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga vendi dhe rreziku gjeografik:
- 1.6.1. Vendet e ndërlidhura me transaksionin bëjnë pjesë në juridiksionet që kanë regjim të PPP/LFT në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe që kanë nivele të ulëta të veprave të ndërlidhura penale.
- 1.7. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga kanalet e ofrimit shërbimeve:
- 1.7.1. Marrëdhëniet e biznesit pa prezencë fizike, kur nuk ekzistojnë masa mbrojtëse shtesë për shembull nënshkrime elektronike, çertifikata elektronike të identifikimit në përputhje me standarde ndërkombëtare të kësaj fushe dhe kur mungojnë kontrollet shtesë të verifikimit të të dhënave.
- 1.7.2. mbështetja në masat e KDK të një palë të tretë në situata kur banka nuk ka një marrëdhënie të gjatë me palën e tretë referuese;
- 1.7.3. kanale të reja të shpërndarjes që ende nuk janë testuar.
- 1.8. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga kanalet e ofrimit shërbimeve:
- 1.8.1. Produkti është i disponueshëm vetëm për klientët që plotësojnë kriteret specifike të përshtatshmërisë të përcaktuara nga autoritetet publike vendore, si në rastin e marrësve të përfitimeve shtetërore.
2. Kur bankat përdorin sisteme të automatizuara për të identifikuar rrezikun e PP/FT që ndërlidhen me marrëdhënie biznesi individuale ose transaksione të rastit dhe për të identifikuar transaksione të dyshimta, ato duhet të sigurojnë që këto sisteme janë të përshtatshme për këto qëllime në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë Udhëzues. Përdorimi i sistemeve të automatizuara të TI nuk duhet të konsiderohet kurrë si një zëvendësim i kujdesit të duhur nga ana e stafit.
- 2.1. Kur rreziku i ndërlidhur me marrëdhënie biznesi ose transaksion të rastit është rritur, bankat duhet të zbatojnë masa KDSH. Këto mund të përfshijnë:
- 2.1.1. Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues në bazë të më shumë se një burimi të besueshëm dhe të pavarur.

- 2.1.2. Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të aksionarëve të tjerë që nuk janë pronar përfitues i klientit ose ndonjë person fizik që ka autoritetin të administrojnë llogari ose jap udhëzime në lidhje me transferimin e fondeve ose transferimin e letrave me vlerë.
- 2.1.3. Marrja e më shumë informacion në lidhje me klientin si dhe natyrën dhe qëllimin e marrëdhënies së biznesit për të ndërtuar një profil më të plotë të klientit, për shembull duke kryer kërkime në media dhe burim të hapur. Shembuj të llojit të informacionit që bankat mund të kërkojnë përfshijnë:
- 2.1.3.1. natyrën e biznesit ose vendin e punësimit të klientit;
  - 2.1.3.2. burimi i pasurisë së klientit dhe burimi i fondeve të klientit që janë të përfshirë në marrëdhëniet e biznesit, për t'u bindur në mënyrë të arsyeshme që këto janë të ligjshme;
  - 2.1.3.3. Qëllimin e transaksionit, përfshirë, kur është e përshtatshme, destinacionin e fondeve të klientit;
  - 2.1.3.4. Informacion për çfarëdo lidhje që klienti mund të ketë me juridiksione të tjera (selitë, objektet operative, degët, etj) dhe individët që mund të ndikojnë në operacionet e tij; ose
  - 2.1.3.5. ku klienti është i vendosur në një vend tjetër, pse ata kërkojnë shërbime nga banka komerciale jashtë juridiksionit të vendit të tyre.
- 2.1.4. Rritja e shpeshtësisë së monitorimit të transaksioneve.
- 2.1.5. Rishikimi dhe, kur është e nevojshme, përditësimi i informacionit dhe dokumentacionit të mbajtur më shpesh. Kur rreziku i lidhur me marrëdhëniet është veçanërisht i lartë, bankat duhet të rishikojnë marrëdhëniet e biznesit çdo vit.
- 2.2. Kur rreziku i ndërlidhur me marrëdhënie biznesi ose transaksion të rastit është i ulët, bankat mund të zbatojnë masa të kujdesit të duhur të thjeshtëzuar. Këto mund të përfshijnë:
- 2.2.1. për klientët që i nënshtrohen regjimit ligjor të licencimit dhe rregullatorit, duhet verifikuar identitetin bazuar në prova që klienti i nënshtrohet këtij regjimi, për shembull përmes kontrollit të regjistrimit publik të rregullatorit;
  - 2.2.2. pranimi i formave alternative të identitetit që plotësojnë kriterin e pavarur dhe të besueshëm të burimit të tilla si shkresa nga një agjenci qeveritare ose organ tjetër publik i besueshëm për klientin, ku ka baza të arsyeshme që klienti të mos jetë në gjendje të sigurojë prova standarde të identitetit dhe me kusht që të mos ketë arsye për dyshime;



## Neni 21

### Udhëzime për marrëdhëniet korrespondente

3. Institucionet financiare duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
  - 3.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 3.1.1. Llogaria mund të përdoret nga bankat e tjera respondente që kanë lidhje të drejtpërdrejta me respondentin, por jo me korrespondentin (nesting or downstream clearing), që nënkupton se korrespondenti jep indirekt shërbime për bankat e tjera që nuk janë respondente.
    - 3.1.2. Llogaria mund të përdoret nga subjektet e tjera brenda grupit të respondentit që nuk kanë qenë subjekt i kujdesit të duhur nga korrespondenti.
    - 3.1.3. Shërbimi përfshin hapjen e llogarive të pagueshme, e cila lejon klientët e respondentit të kryejnë transaksione direkt në llogarinë e respondentit.
  - 3.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 3.2.1. Marrëdhënia është e kufizuar në kapacitetet e SWIFT RMA, e cila është krijuar për të menaxhuar komunikimet ndërmjet institucioneve financiare. Në marrëdhënie SWIFT RMA, respondenti ose pala e kundërt nuk ka marrëdhënie me llogari të pagueshme.
    - 3.2.2. Bankat veprojnë në llogari të tyre në vend se të realizojnë transaksione në emër të klientëve të tyre, shembull në rastin e shërbimeve të këmbimit valutor në mes të dy bankave dhe nuk përfshihen palët e treta. Në këto raste transaksioni realizohet për llogari të vet bankës respondente.
    - 3.2.3. Transaksioni ka të bëjë me shitjen, blerjen ose zotërimin e letrave me vlerë në tregjet e rregulluara.
  - 3.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti:
    - 3.3.1. Politikat për PPP/LFT të respondentit dhe sistemet dhe kontrollet që respondenti aplikon nuk janë në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore në fuqi.
    - 3.3.2. Respondenti nuk i nënshtrohet mbikëqyrjes adekuate të PPP/ LFT.
    - 3.3.3. Respondenti apo grupi të cilin i përket, së fundmi ka qenë subjekt i ndëshkimit apo masave administrative për shkelje të obligimeve të PPP/LFT.
    - 3.3.4. Respondenti zhvillon biznes të konsiderueshëm me sektorë që shoqërohen me nivele më të larta të rrezikut të PP/FT; për shembull, respondenti zhvillon biznes me

remitanca ose biznese të konsiderueshëm të dërgesave në emër të remituesve të caktuar ose zyreve të këmbimit, me jo-rezidentë ose në valuta tjetër përveç asaj të vendit në të cilin është i themeluar.

- 3.3.5. Menaxhmenti apo pronësia e respondentit përfshin PEP, në veçanti kur PEP mund të ushtroj ndikim domethënës tek respondentit, nga ku reputacioni, integriteti ose përshtatshmëria e PEP-it si anëtar i bordit drejtues ose mbajtësi i funksionit kryesor krijon shqetësim, ose kur PEP është nga një juridiksion i lidhur me rrezik më të lartë për PP/FT. Institucionet financiare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë atyre juridiksioneve ku korrupsioni perceptohet të jetë sistemik ose i përhapur.
  - 3.3.6. Historia e marrëdhënies së biznesit me respodentin shkakton shqetësim, për shembull sepse shuma e transaksioneve nuk është në përputhje me atë që korrespondenti pret bazuar në njohuritë për natyrën dhe madhësinë e respodentit.
  - 3.3.7. Respodenti dështon të ofrojë informacionet e kërkuara nga korrespondenti lidhur me KDK, KDSH dhe informacionin paguesin apo përfituesin.
- 3.4. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga klienti:
- 3.4.1. Kontrollat për PPP/LFT të respodentit nuk janë më pak të fuqishëm se ato të kërkuara nga standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi;
  - 3.4.2. Respodenti është pjesë e të njëjtit grup si korrespondenti, nuk është i bazuar në një juridiksion të lidhur me rrezik më të lartë për PP/FT dhe zbaton në mënyrë efektive me standardet e grupit për PPP që nuk janë më pak të rrepta se ato të kërkuara nga standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi.
- 3.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendi ose aspekti gjeografik:
- 3.5.1. Respodenti është i bazuar në juridiksion të lidhur me rrezik më të lartë të PP/FT. Institucionet financiare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve të cilat:
    - 3.5.1.1. janë të identifikuar si vende me rrezik të lartë të PP/FT
    - 3.5.1.2. me nivel të konsiderueshëm korrupsioni dhe/ose vepra të tjera të ndërlidhura për pastrimin e parave;
    - 3.5.1.3. pa kapacitete adekuate të sistemit juridik dhe gjyqësor për të ndjekur në mënyrë efektive veprat penale;
    - 3.5.1.4. pa mbikëqyrje efektive për PPP/LFT
    - 3.5.1.5. me nivel të konsiderueshëm të financimit të terrorizmit apo aktiviteteve terroriste.



- 3.5.2. Respondenti zhvillon biznes të konsiderueshëm me klientë të bazuar në juridiksione të lidhura me rrezik më të lartë për PP/FT.
- 3.5.3. Selia qendrore amë e respondentit është e themeluar në një juridiksion të lidhur me rrezik më të lartë të PP/FT.
- 3.6. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga vendi ose aspekti gjeografik:
- 3.6.1. klienti është nga një vend i BE-së ose një vend që ka krijuar një sistem efektiv për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i cili nuk është nën sanksione, embargo ose ndonjë masë të ngjashme;
4. Të gjithë korrespondentët duhet të kryejnë masat e KDK-së ndaj respondentit, i cili është klienti i korrespondentit, mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut. Kjo nënkupton që korrespondentët duhet:
- 4.1. Identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e respodentit dhe pronarit të tijtë tij përfitues. Si pjesë e kësaj, korrespondentët duhet të marrin informacion të mjaftueshëm në lidhje me biznesin dhe reputacionin e respodentit për të vërtetuar se rreziku i pastrimit të parave të lidhur me respodentit nuk është rritur. Në veçanti, korrespondentët duhet:
- 4.1.1. të marrin informacion në lidhje me menaxhmentin e respodentit dhe të marrin në konsideratë rëndësinë, për qëllime të parandalimit të krimit financiar, të çdo lidhje që menaxhmenti apo pronësia e respodentit mund të ketë me PEP ose individë të tjerë me rrezik të lartë; dhe
- 4.1.2. konsiderojnë, mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut, nëse merren informacione në lidhje me biznesin kryesor të respodentit, llojet e klientëve që tërheq, dhe cilësinë e sistemeve dhe kontrolleve të tij për PPP (përfshirë informacionin e disponueshëm publikisht për çdo sanksion nga rregullatori ose ndëshkim penal të kohëve të fundit për dështimet për PPP) është e përshtatshme. Kur respodenti është degë, filial ose bashkëpunëtor, korrespondentët gjithashtu duhet të marrin parasysh statusin, reputacionin dhe kontrollet e PPP të selisë amë
- 4.1.3. Krijojnë dhe dokumentojnë natyrën dhe qëllimin e shërbimit të ofruar, si dhe përgjegjësitë e secilit institucion. Kjo mund të përfshijë përcaktimin, me shkrim, qëllimin e fushëveprimit, cilat produkte dhe shërbime ofrohen, dhe si dhe nga kush dhe si mund të përdoret lehtësimi i bankimit korrespondent (p.sh. nëse mund të përdoret nga bankat e tjera përmes marrëdhënieve të tyre me respondent).
- 4.1.4. Monitorimi i marrëdhënieve të biznesit, përfshirë transaksionet, për të identifikuar ndryshimet në profilin e rrezikut të respodentit dhe për të identifikuar sjellje të pazakonta ose të dyshimta, duke përfshirë aktivitete që nuk janë në përputhje me qëllimin e shërbimeve të ofruara ose që janë në kundërshtim me angazhimet që janë lidhur midis korrespondentit dhe respodentit. Kur banka korrespondente lejon

klientët e responentit qasje të drejtpërdrejtë në llogari (p.sh. llogari të pagueshme, ose llogari nested), ajo duhet të kryejë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit. Për shkak të natyrës së bankave korrespondente, monitorimi pas ekzekutimit është obligativ.

4.1.5. Sigurohet që informacionet e KDK që mbajnë janë të përditësuara.

## Neni 22

### Udhëzime për financimin e tregtisë

1. Bankat gjatë financimit të tregtisë duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
  - 1.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga transaksionet:
    - 1.1.1. Transaksioni është jashtëzakonisht i madh duke pasur parasysh atë që dihet për veprimtarinë e mëparshme tregtare të klientit.
    - 1.1.2. Transaksioni është shumë i strukturuar, i fragmentuar ose kompleks, duke përfshirë palë të shumta, pa ndonjë arsytim të dukshëm legjitim.
    - 1.1.3. Kopjet e dokumenteve përdoren në situata kur nevojitet dokumentacion origjinal, pa sqarime të arsyeshme.
    - 1.1.4. Ekzistojnë mospërputhje e rëndësishme në dokumentacion, për shembull midis përshkrimit të mallrave në dokumentet kryesore (d.m.th. faturat dhe dokumentet e transportit) dhe mallrat aktuale të dërguara, në masën që kjo është e dukshme.
    - 1.1.5. Lloji, sasia dhe vlera e mallrave janë në kundërshtim me njohuritë e bankës për biznesin e blerësit.
    - 1.1.6. Mallrat e shkëmbyera janë me rrezik më të lartë për qëllime të pastrimit të parave, për shembull disa mallra, çmimet e të cilave mund të luhaten në mënyrë të konsiderueshme, gjë që mund të bëjë që çmimet vështirë të zbulohen.
    - 1.1.7. Mallrat e shkëmbyera kërkohet licencë eksporti.
    - 1.1.8. Dokumentacioni tregtar nuk përputhet me ligjet ose standardet në fuqi.
    - 1.1.9. Çmimi për njësi duket i pazakontë, bazuar në atë që banka di për mallrat dhe tregtinë.
    - 1.1.10. Transaksioni përndryshe është i pazakontë, për shembull Dokumenti për Letër Kredinë ndryshohet shpesh pa një arsytim të qartë ose mallrat dërgohen përmes një juridiksioni tjetër për asnjë arsye të dukshme tregtare.
  - 1.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga transaksionet:
    - 1.2.1. Agjentët e pavarur të inspektimit kanë verifikuar cilësinë dhe sasinë e mallrave.



1.2.2. Transaksionet përfshijnë palë që kanë krijuar marrëdhënie biznesi dhe që kanë histori të dëshmuar të transaksioneve me njëri-tjetrin dhe kujdesi i duhur për ta është kryer më parë.

1.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti:

1.3.1. Transaksioni dhe/ose palët e përfshira nuk janë në përputhje me ato që banka di për veprimtarinë e mëparshme të klientit ose linjën e biznesit (p.sh. mallrat që dërgohen, ose vëllimet e transportit, nuk janë në përputhje me ato që dihen për biznesin e importuesit ose eksportuesit).

1.3.2. Ekzistojnë indikacione se blerësi dhe shitësi mund të jenë bashkëpunëtorë, për shembull:

1.3.2.1. blerësi dhe shitësi kontrollohen nga i njëjti person;

1.3.2.2. bizneset në transaksione kanë të njëjtën adresë, ofrojnë vetëm adresën e një agjenti të regjistruar ose kanë mospërputhje të adresave të tjera;

1.3.2.3. blerësi dëshiron dhe është i gatshëm për të pranuar ose hequr dorë nga mospërputhjet në dokumentacion.

1.3.3. Konsumatori nuk është në gjendje ose nuk ka dëshirë të sigurojë dokumentacionin përkatës për të mbështetur transaksionin.

1.3.4. Blerësi përdor agjentë ose palë të treta.

1.3.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut:

1.3.6. Konsumatori është një klient ekzistues, biznesi i të cilit është i njohur mirë për bankën dhe transaksioni është në përputhje me atë biznes.

1.3.7. Konsumatori renditet në bursë që plotëson kërkesat për deklarime të ngjashme me ato të BE-së.

1.4. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga klienti:

1.4.1. Konsumatori është një klient ekzistues, biznesi i të cilit është i njohur mirë për bankën dhe transaksioni është në përputhje me atë biznes.

1.4.2. Konsumatori renditet në bursë që plotëson kërkesat për deklarime të ngjashme me ato të BE-së.

1.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendi dhe gjeografik:

1.5.1. Vendi i lidhur me transaksionin (përfshirë atë kur mallrat kanë origjinën, për të cilat ato janë destinuar, ose për të cilat kanë kaluar përmes transaksionit, ose atë ku secila palë në transaksion është i bazuar) ka kontrole të këmbimit të valutave. Kjo rrit rrezikun që qëllimi i vërtetë i transaksionit të eksportoje valutë në kundërshtim me ligjin vendor.

- 1.5.2. Vend i lidhur me transaksionin ka nivele më të larta të veprave të ndërlidhura penale (p.sh. ato që lidhen me tregtinë e narkotikëve, kontrabandën ose falsifikimin) ose zonat e tregtisë së lirë.
- 1.6. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga vendi dhe gjeografik:
  - 1.6.1. Tregtia është brenda BE/Zonës Ekonomike Evropiane.
  - 1.6.2. Vendet e ndërlidhura me transaksionin duhet të kenë një regjim të PPP/në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe shoqërohen me nivele të ulëta të veprave të ndërlidhura penale.
2. Kur një bankë ofron shërbime të financimit të tregtisë për një klient, ajo duhet të ndërmarrë hapa, si pjesë e procesit të saj për KDK, për të kuptuar biznesin e klientit. Shembuj të llojit të informacionit që banka mund të merr përfshijnë vendet me të cilat tregton klienti, cilat rrugë tregtie përdoren, cilat mallra tregtohen, me kë klient bën biznes (blerësit, furnitorët, etj.), a përdor klienti agjentë ose palë të treta, dhe nëse po, ku bazohen këta agjentë apo palë të treta. Kjo ndihmon bankat të kuptojnë se kush është klienti dhe të ndihmojë në zbulimin e transaksioneve të pazakonta ose të dyshimta.

## **Neni 23**

### **Udhëzime për emetuesit e parasë elektronike**

1. Emetuesit e parasë elektronike duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
  - 1.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 1.1.1. pagesa me vlerë të lartë ose me vlerë të pakufizuar, mbushjen dhe rimbushjen, përfshirë tërheqjen në para të gatshme;
    - 1.1.2. pagesa me vlerë të lartë, mbushjen dhe rimbushjen, përfshirë tërheqjen në para të gatshme;
    - 1.1.3. shuma të larta ose të pakufizuara të fondeve që duhet të ruhen në produktin/ llogarinë e-Money
    - 1.1.4. financohet me pagesa nga palë të treta të pidentifikuara
    - 1.1.5. financuar me produkte të tjera të parasë elektronike
    - 1.1.6. lejon transferime nga personi në person;
    - 1.1.7. pranohet si mënyrë pagese nga një numër i madh i tregtarëve ose pikave të shitjes;



- 1.1.8. është krijuar posaçërisht për tu pranuar si mjet pagese nga tregtarët që merren me mallra dhe shërbime të ndërlidhura me rrezik të lartë të krimit financiar, për shembull bixhozi në internet;
  - 1.1.9. mund të përdoret në transaksione ndërkufitare ose në juridiksione të ndryshme;
  - 1.1.10. është krijuar për t'u përdorur nga persona të ndryshëm përveç klientëve, për shembull produkte të caktuara të kartave "partner card" (por jo kart dhuratë me vlerë të ulët);
  - 1.1.11. lejon tërheqje të parave në të gatshme me vlerë të lartë.
- 1.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
- 1.2.1. vendos kufij me vlerë të ulët për pagesa, mbushjen dhe rimbushjen, përfshirë tërheqjen e parave të gatshme (megjithëse institucionet financiare duhet të kenë parasysh që vetëm një prag i ulët mund të mos jetë i mjaftueshëm për të zvogëluar rrezikun e FT);
  - 1.2.2. kufizon numrin e pagesave, mbushjen dhe rimbushjen, përfshirë tërheqjen e parave në një periudhë të caktuar;
  - 1.2.3. kufizon sasinë e fondeve që mund të ruhen në produktin / llogarinë e parave elektronike në çdo kohë.
  - 1.2.4. kërkon që fondet për blerje ose mbushje të tërhiqen në mënyrë të verifikueshme nga një llogari e mbajtur në emrin e tij ose të përbashkët të klientit në një bankë ose institucion financiar;
  - 1.2.5. nuk lejon ose kufizon rreptësisht tërheqjen e parave në të gatshme;
  - 1.2.6. mund të përdoret vetëm brenda vendit;
  - 1.2.7. pranohet nga një numër i kufizuar i tregtarëve ose nga pikat e shitjes, me biznesin e të cilëve emetuesi i parave elektronike është i njohur;
  - 1.2.8. është krijuar posaçërisht për të kufizuar përdorimin e tij nga tregtarët që merren me mallra dhe shërbime që ndërlidhen me rrezik të lartë të krimit financiar;
  - 1.2.9. pranohet si mjet pagese për llojet e kufizuara të shërbimeve ose produkteve me rrezik të ulët.
- 1.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti:
- 1.3.1. Klienti blen disa produkte të parasë elektronike nga i njëjti emetues, shpesh rimbush produktin ose bën disa tërheqje të parave në periudhë të shkurtër kohe dhe pa një arsyetim ekonomik;
  - 1.3.2. Transaksionet e klientit janë gjithmonë nën çdo kufi të vlerës/transaksionit;

- 1.3.3. Produkti duket se përdoret nga disa persona, identiteti i të cilëve nuk është i njohur për emetuesit (p.sh. produkti përdoret nga disa IP adresa në të njëjtën kohë);
- 1.3.4. Ka ndryshime të shpeshta në të dhënat e identifikimit të klientit, të tilla si adresa e shtëpisë ose IP adresa, ose llogaritë bankare të ndërlidhura;
- 1.3.5. Produkti nuk përdoret për qëllimin për të cilin është krijuar.
- 1.4. Faktori i mëposhtëm mund të kontribuojë në uljen e rrezikut nga klienti:
- 1.4.1. Produkti është në dispozicion vetëm për disa kategori klientësh, për shembull përfitues të skemave shoqërore ose anëtarëve të stafit të kompanisë që i lëshon ato për të mbuluar shpenzimet e korporatës.
- 1.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga kanalet e shpërndarjes:
- 1.5.1. Shpërndarja në internet dhe pa prezencë fizike pa masa mbrojtje adekuate, të tilla si nënshkrimet elektronike, dokumentet elektronike të identifikimit që plotësojnë standardet ndërkombëtare të fushës dhe masat kundër mashtrimit të identitetit.
- 1.5.2. Shpërndarja përmes ndërmjetësve që vetë nuk janë subjekte raportuese sipas Ligjit për PPP/LFT, kur është e aplikueshme, kur emetuesi i parave elektronike:
- 1.5.2.1. mbështetet në ndërmjetësin për të realizuar disa nga detyrimet për PPP/LFT të emetuesit të parave elektronike; dhe
- 1.5.2.2. nuk e ka bindur veten që ndërmjetësi ka krijuar sisteme dhe kontrolle adekuate të PPP/LFT.
- 1.5.2.3. ndarja e shërbimeve, domethënë ofrimi i shërbimeve të parave elektronike nga disa ofrues të shërbimeve të pavarur operacionalisht pa mbikëqyrje dhe koordinim të duhur.
- 1.5.3. Institucioni, përpara nënshkrimit të një marrëveshje shpërndarjeje me një tregtar, duhet të kuptojnë natyrën dhe qëllimin e biznesit të tregtarit për t'u kënaqur që mallrat dhe shërbimet e ofruara janë legjitime dhe për të vlerësuar rrezikun e PP/TF që lidhet me biznesin e tregtarit. Në rastin e një tregtari që ofron shërbime përmes internetit, institucionet financiare duhet gjithashtu të ndërmarrin hapa për të kuptuar llojin e klientëve që tërheq ky tregtar dhe të përcaktojnë vëllimin dhe madhësinë e pritur të transaksioneve në mënyrë që të dallojnë transaksione të dyshimta ose të pazakonta
- 1.6. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendi ose rrezikut gjeografik:
- 1.6.1. Paguesi është i vendosur në, ose produkti merr fonde nga burime në, një juridiksion i ndërlidhur me rrezik më të lartë të PP/TF. Institucionet financiare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve të njohura për sigurimin e fondeve ose mbështetjes për aktivitete terroriste ose kur grupet që kryejnë vepra terroriste dihet se



operojnë në ato zona, dhe juridiksionet janë subjekt i sanksioneve financiare, embargoeve ose masave që kanë të bëjnë me terrorizmin, financimin e terrorizmit ose përhapjen.

2. Kur rreziku i ndërlidhur me marrëdhënie biznesi ose transaksion të rastit është rritur, duhet të zbatohen masat e KDSH. Këto mund të përfshijnë:
  - 2.1. marrja e informacionit shtesë të klientit gjatë identifikimit, siç është burimi i fondeve;
  - 2.2. duke aplikuar masa shtesë verifikimi nga një larmi më e madhe burimesh të besueshme dhe të pavarura (p.sh. kontrolli në bazat të dhënave në internet) me qëllim të verifikimit të identitetit të klientit ose pronarit përfitues;
  - 2.3. marrja e informacionit shtesë për natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit, për shembull duke pyetur klientët në lidhje me biznesin e tyre ose juridiksionet në të cilat ata synojnë të transferojnë paratë elektronike;
  - 2.4. marrja e informacionit në lidhje me tregtarin/paguesin, veçanërisht kur emetuesi i parave elektronike ka arsye të dyshojë se produktet e tij janë duke u përdorur për të blerë mallra të paligjshme ose të kufizuara për përdorim për shkak të moshës;
  - 2.5. aplikimi i kontroleve kundër mashtrimit të identitetit për të siguruar që klienti është ai që pretendon të jetë;
  - 2.6. aplikimi i monitorimit të zgjeruar në marrëdhëniet me klientët dhe transaksionet individuale;
  - 2.7. përcaktimi i burimit dhe/ose destinacionit të fondeve.
3. Kur rreziku i ndërlidhur me marrëdhënie biznesi ose transaksion të rastit është i ulët, institucionet financiare mund të zbatojnë masa të kujdesit të duhur të thjeshtëzuar. Këto mund të përfshijnë:
  - 3.1. verifikimin e identitetit të klientit në bazë të pagesës së tërhequr në llogari në emër të vet ose të përbashkët të klientit ose llogari për të cilën klienti mund të dëshmon se ka mbikëqyrje nga një bankë apo institucion financiar i rregulluar.
  - 3.2. verifikimin e identitetit në bazë të disa burimeve;
  - 3.3. verifikimin e identitetit në bazë të burimeve më pak të besueshme;
  - 3.4. duke përdorur metoda alternative për të verifikuar identitetin;
  - 3.5. duke supozuar natyrën dhe qëllimin e synuar të marrëdhënies së biznesit, kur kjo është e dukshme, për shembull në rastin e disa kartave të dhuratave që nuk përfshihen nën rrethin e mbyllur / përjashtimin e rrjetit të mbyllur;

## Neni 24

### Udhëzime për institucionet e transfereve të parave

1. Institucionet e transfereve të parave duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
  - 1.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 1.1.1. produkti lejon transaksione me vlera të larta ose me vlerë të pakufizuar;
    - 1.1.2. produkti ose shërbimi ka shtrirje globale;
    - 1.1.3. transaksioni është i bazuar në para të gatshme ose financohet me para elektronike anonime;
    - 1.1.4. transferimet bëhen nga një ose më shumë pages në vende të ndryshme tek një përfitues lokal.
  - 1.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 1.2.1. fondet e përdorura gjatë transferimit vijnë nga një llogari e mbajtur në emrin e pagesit në një bankë ose institucion financiar vendor.
  - 1.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti:
    - 1.3.1. Klienti zotëron ose udhëheqë biznes që merret me qarkullim të madh të parave në të gatshme.
    - 1.3.2. Biznesi i klientit ka strukturë të ndërlikuar të pronësisë
    - 1.3.3. Aktiviteti i klientit mund të lidhet me financimin e terrorizmit sepse ai njihet publikisht për prirje ekstremiste ose dihet se është i lidhur me një grup krimi të organizuar.
    - 1.3.4. Nevojat e klientit mund të shërbejnë më mirë diku tjetër, për shembull sepse agjensioni i transfereve të parave nuk është lokal për klientin ose biznesin e klientit.
    - 1.3.5. Klienti duket se po vepron për dikë tjetër, për shembull klienti është nën vëzhgim të personave tjerë ose shihen jashtë vendit ku bëhet transaksioni, ose klienti lexon udhëzime nga shënimet.
    - 1.3.6. Sjellja e klientit nuk ka asnjë kuptim të dukshëm ekonomik, për shembull klienti pranon një kurs të dobët këmbimi ose tarifa të larta pa bërë pyetje, kërkon transaksione në valuta që nuk janë zyrtare që përdoren zakonisht në juridiksionin ku ndodhet klienti dhe/ose marrësi ose kërkon ose sjell sasi të mëdha valutash vlera e të cilave mund të ulet ose rritet.

h.



- 1.3.7. Transaksionet e klientit janë gjithmonë nën pragjet e aplikueshme, përfshirë pragun e KDK për transaksione të rastit të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
- 1.3.8. Përdorimi i shërbimit të klientit është i pazakontë, për shembull dërgon ose pranon para nga vetvetja për veten ose dërgon fonde menjëherë pas pranimit të tyre.
- 1.3.9. Klienti duket se di shumë pak ose nuk ka dëshirë të sigurojë informacione rreth transferuesit.
- 1.3.10. Disa nga klientët transferojnë fonde tek i njëjtin përfitues ose duket se kanë të njëjtin informacion identifikimi, për shembull adresën ose numrin e telefonit.
- 1.3.11. Transaksion në hyrje nuk shoqërohet me informacionin e kërkuar mbi dërguesin ose pranuesin.
- 1.3.12. Shuma e dërguar ose marrë është në kundërshtim me të ardhurat e klientit (nëse dihet).
- 1.4. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga klienti:
- 1.4.1. Klienti është i njohur prej shumë kohësh, sjellja e së kaluarës e së cilit nuk ka ngritur dyshime dhe nuk ka indikacione se rreziku i PP/FT mund të rritet.
- 1.4.2. Shuma e transferuar është e ulët; sidoqoftë, institucionet financiare duhet të kenë parasysh që vetëm vlera e ulët nuk është e mjaftueshme për të ulur rrezikun e FT.
- 1.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga kanalet e ofrimit të shërbimeve:
- 1.5.1. Nuk ka kufizime në instrumentin e financimit, për shembull në rastin e parave të gatshme ose pagesa nga produkte të parasë elektronike, transfer elektronik ose çeqe.
- 1.5.2. Kanali i shpërndarjes i përdorur ofron një shkallë anonimiteti.
- 1.5.3. Shërbimi ofrohet plotësisht në internet pa masa mbrojtëse të përshtatshme.
- 1.5.4. Shërbimi i dërgesave të parave ofrohet përmes agjentëve që:
- 1.5.4.1. përfaqësojnë më shumë se një udhëheqës;
- 1.5.4.2. kanë tipologji qarkullimi të pazakontë në krahasim me agjentë të tjerë në vendndodhje të ngjashme, për shembull numër jashtëzakonisht të lartë ose të ulët transaksionesh, transaksione jashtëzakonisht të shumta parash në të gatshme ose një numër të lartë transaksionesh që bien nën pragun e KDK, ose bëjnë biznes jashtë orarit normal të biznesit;
- 1.5.4.3. një pjesë të madhe të biznesit e bëjnë me dërguesit ose pranuesit nga juridiksionet e lidhura me rrezik më të lartë të PP/FT;
- 1.5.4.4. duket të jenë të pasigurt në lidhje me zbatimin e politikave të PPP/LFT në kuadër të grupit; ose

- 1.5.4.5.nuk janë nga sektori financiar dhe kryejnë biznes tjetër si biznesi i tyre kryesorë.
- 1.5.5.Shërbimi i dërgesave të parave sigurohet përmes një zinxhiri pagese tepër kompleks, për shembull me një numër të madh ndërmjetësish që operojnë në juridiksione të ndryshme ose lejojnë sisteme të pagjurmueshme të krijuara (formale dhe informale).
- 1.6. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga kanalet e ofrimit të shërbimeve:
- 1.6.1.Agjentët janë vetë subjekte raportuese të rregulluara.
- 1.6.2.Shërbimi mund të financohet vetëm me transferime nga një llogari e mbajtur në emrin e klientit në një bankë ose institucion financiar ose një llogari mbi të cilën klienti mund të dëshmon se ka kontroll.
- 1.7. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendet apo rrezikut gjeografik:
- 1.7.1.Paguesi ose marrësi i pagesës ndodhet, ose transaksioni është ekzekutuar nga një IP adresë në një juridiksion të lidhur me rrezik më të lartë të PP/TF. Institucionet financiare duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve që dihet se ofrojnë financim ose mbështetje për aktivitete terroriste ose ku dihet se veprojnë grupet që kryejnë vepra terroriste, dhe juridiksionet që i nënshtrohen sanksioneve financiare, embargove ose masave që lidhen me terrorizmin, financimin e terrorizmit ose përhapjen e armëve.
- 1.7.2.Marrësi i pagesës është rezident në një juridiksion që nuk ka sektor bankar formal ose është më pak i zhvilluar, që nënkupton se shërbimet informale të dërgesave të parave, të tilla si *hawala*.
- 1.7.3.Pala e kundërt e institucionit ndodhet në një vend të tretë të lidhur me rrezik më të lartë të PP/FT.
- 1.7.4.Paguesi ose marrësi i pagesës ndodhet në një vend të tretë me rrezik të lartë.
2. Meqenëse biznesi i institucioneve të transfereve të parave është kryesisht i bazuar në transaksione, duhet të merren në konsideratë se cilat sisteme monitorimi dhe kontrole vendosin për të siguruar që ata të zbulojnë tentimet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit edhe kur informacioni për KDK që ata mbajnë mbi klientin është bazik ose mungon sepse nuk është krijuar asnjë marrëdhënie biznesi.
3. Institucionet e transfereve të parave, në çdo rast duhet të vendosin:
- 3.1. sisteme për të identifikuar transaksionet e ndërlidhura;
- 3.2. sisteme për të identifikuar nëse transaksionet nga klientë të ndryshëm janë të destinuara për të njëjtin përfitues;



- 3.3. sisteme për të lejuar sa më shumë të jetë e mundur krijimin e burimit të fondeve dhe destinacionin e fondeve;
  - 3.4. sisteme që lejojnë gjurmueshmërinë e plotë të të dy transaksioneve dhe numrin e operatorëve të përfshirë në zinxhirin e pagesave; dhe
  - 3.5. sisteme për të siguruar që gjatë gjithë zinxhirit të pagesave vetëm ata të autorizuar zyrtarisht të ofrojnë shërbime të dërgesave të parave mund të ndërhyjnë.
4. Kur rreziku i lidhur me transaksionet e rastit ose marrëdhënie biznesi është rritur, institucionet e transfereve të parave duhet të aplikojnë masat e kujdesit të duhur të shtuar, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, rritjen e monitorimit të transaksioneve (p.sh. frekuenca e rritur ose pragje më të ulëta). Në të kundërt, kur rreziku i ndërlidhur me transaksion të rastit ose marrëdhënie biznesi është i ulët, institucionet e transfereve të parave mund të zbatojnë masat e kujdesit të duhur të thjeshtëzuar në pajtueshmëri me masat e përcaktuara në këtë udhëzues.
  5. Institucionet e transfereve të parave që përdorin agjentët për të siguruar shërbimet duhet të dinë se kush janë agjentët e tyre. Si pjesë e kësaj, institucionet e transfereve të parave duhet të krijojnë dhe të mbajnë politika dhe procedura të përshtatshme dhe të bazuara në rrezik për të luftuar rrezikun që agjentët e tyre mund të përfshihen, ose të përdoren për PP/FT, duke përfshirë:
    - 5.1. Identifikimin e personit i cili zotëron ose kontrollon agjentin, kur agjenti është person juridik, për tu bindur që rreziku i PP/FT, ndaj të cilit ekspozohet institucioni i transfereve të parave, si rezultat i përdorimit të këtij agjentit, nuk është rritur.
    - 5.2. Marrja e dokumenteve, që drejtorët dhe personat e tjerë përgjegjës për administrimin e agjentit janë persona të aftë dhe të duhur, përfshirë këtu duke konsideruar kriterin për i përshtatshëm dhe i duhur, integritetin dhe reputacionin. Çfarëdo verifikimi që i bën institucioni i transfereve të parave duhet të jetë në përpjesëtim me natyrën, kompleksitetin dhe shkallën e rrezikut të PP/FT, të cilin e ka të përhershëm në shërbimet e dërgesave të ofruara nga agjenti dhe mund të bazohet në procedurat e KDK të institucionit të transfereve të parave
    - 5.3. Marrja e masave të arsyeshme për të bindur veten që kontrollet e brendshme të agjentit për PPP/LFT janë të përshtatshme dhe mbeten të përshtatshme gjatë gjithë marrëdhënies, për shembull duke monitoruar një mostër të transaksioneve të agjentit ose duke rishikuar kontrollet e agjentit në vend. Kur kontrollet e brendshme të agjentëve për PPP/LFT ndryshojnë nga ato të institucionit të transfereve, për shembull sepse agjenti përfaqëson më shumë se institucionit i transfereve të parave ose sepse agjenti është vetë subjekt raportues sipas legjislacionit të zbatueshëm për PPP/LFT, institucionit i transfereve të parave duhet të vlerësojë dhe menaxhojë rrezikun që këto ndryshime mund të ndikojnë tek ai, dhe në pajtueshmërinë e agjentit për PPP/LFT.

1.

- 5.4. Sigurimi i trajnimeve për PPP/LFT për agjentët për të siguruar që agjentët të kenë një kuptim adekuat të rreziqeve përkatëse të PP/FT dhe cilësinë e kontrolleve për PPP/LFT të cilin institucionit i transfereve të parave e pret ta ketë.

## Neni 25

### Udhëzime për kompanitë e sigurimeve

1. Siguruesit duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
  - 1.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 1.1.1. Fleksibiliteti i pagesave që produkti lejon, për shembull:
      - 1.1.1.1. pagesa nga palë të treta të paidentifikuara;
      - 1.1.1.2. pagesat e primit me vlerë të lartë ose me vlerë të pakufizuar, mbi-pagesa ose vëllime të mëdha të primeve me vlerë më të ulët;
      - 1.1.1.3. pagesa në para në të gatshme
    - 1.1.2. Lehtësia e hyrjes në fondet e akumuluar, për shembull produkti lejon tërheqje të pjesshme ose dorëzim të parakohshëm në çdo kohë, me tarifa të kufizuara ose komisione.
    - 1.1.3. Negociueshmëria, për shembull produkti mund të:
      - 1.1.3.1. shitet në një treg sekondar;
      - 1.1.3.2. përdoret si kolateral për një kredi.
    - 1.1.4. Anonimiteti, për shembull produkti lejon ose lehtëson anonimitetin e klientit.
  - 1.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
    - 1.2.1. nuk ka asnjë element investimi;
    - 1.2.2. nuk ka lehtësira pagese ndaj palëve të treta;
    - 1.2.3. kërkon që investimi i përgjithshëm të zvogëlohet me një vlerë të ulët;
    - 1.2.4. është një polisë e sigurimit të jetës ku primi është i ulët;
    - 1.2.5. lejon vetëm pagesa të rregullta të primeve me vlera të vogla, për shembull pa mbi-pagesa;
    - 1.2.6. është i arritshëm vetëm përmes punëdhënësve, për shembull pensioni, kontributi pensional ose skemë e ngjashme që siguron përfitime pensioni për punonjësit, ku



kontributet bëhen përmes zbritjes nga pagat dhe rregullat e skemës nuk lejojnë caktimin e interesit të një anëtarit sipas skemës;

1.2.7. nuk mund të rikthehet në një afat të shkurtër ose të mesëm, si në rastin e skemave pensionale pa mundësi të dorëzimit të hershëm;

1.2.8. nuk mund të përdoret si kolateral;

1.2.9. nuk lejon pagesa në para në të gatshme;

1.2.10. ka kushte që duhet të përmbushen për të përfituar nga lehtësirat tatimore.

1.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti dhe përfituesit:

1.3.1. personat juridikë, struktura e të cilëve vështirëson identifikimin e pronarit përfitues;

1.3.2. klienti ose pronari përfitues i klientit është PEP;

1.3.3. përfituesi i polisës ose pronari përfitues i këtij përfituesi është PEP;

1.3.4. mosha e klientit është e pazakontë për llojin e produktit të kërkuar (p.sh. klienti është shumë i ri ose shumë i vjetër);

1.3.5. kontrata nuk përputhet me gjendjen e pasurisë së klientit;

1.3.6. profesioni ose aktivitetet e klientit konsiderohen si veçanërisht të predispozuara që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, për shembull sepse dihet që ka të bëjë qarkullim me të madhë të parave në të gatshme ose të ekspozuara ndaj një rreziku të lartë korrupsioni;

1.3.7. kontrata regjistrohet nga një "mbajtës i parave", siç është një kompani fiduciare, që vepron në emër të klientit;

1.3.8. mbajtësi i polisës dhe/ose përfituesi i kontratës janë kompani me aksionarë të emëruar dhe/ose aksione në formë bartëse.

1.3.9. klienti shpesh transferon kontratën te një sigurues tjetër;

1.3.10. anulime të shpeshta dhe të pashpjegueshme, veçanërisht kur rimbursimi bëhet në llogari të ndryshme bankare;

1.3.11. klienti bënë përdorime të shpeshta ose të papritura të dispozitave "free lock"/"cooling off" periudha, veçanërisht kur kthimi i rimbursimit i bëhet një pale të tretë që në dukje duket se nuk janë të ndërlidhur;<sup>1</sup>

1.3.12. klienti shkakton kosto të lartë duke kërkuar përfundimin e hershëm të një produkti;

---

<sup>1</sup> Dispozita 'free lock' është një dispozitë kontraktuale, shpesh e detyrueshme në bazë të ligjit vendor, e cila lejon një pronar të polisës ose anuitant të një sigurimi të jetës ose një kontrate pensioni të shqyrtojë një kontratë për një numër të caktuar ditësh dhe ta kthejë atë për një rimbursim të plotë.

- 1.3.13. klienti transferon kontratën tek një palë e tretë që në dukje duket se nuk ka ndërlidhje;
  - 1.3.14. kërkesa e klientit për të ndryshuar ose rritur shumën e siguruar dhe/ose pagesa e primit janë të pazakonta ose të larta;
  - 1.3.15. siguruesi njoftohet për ndryshim në përfitues vetëm kur është bërë kërkesë;
  - 1.3.16. klienti ndryshon klauzolën e përfituesit dhe emëron një palë të tretë që në dukje nuk janë të ndërlidhur;
  - 1.3.17. siguruesi, klienti, pronari përfitues, përfituesi ose pronari përfitues i përfituesit janë në juridiksione të ndryshme.
  - 1.3.18. konsumatori përdor metoda të pazakonta pagese, të tilla si mjete monetare të strukturuar ose forma të tjera të mjeteve të pagesave që nxisin anonimitet;
  - 1.3.19. pagesa nga llogari të ndryshme bankare pa sqarime;
  - 1.3.20. pagesa nga bankat që nuk janë të vendosura në vendin e banimit të klientit;
  - 1.3.21. klienti bën pagesa të shpeshta ose në vlera të lartë, kur kjo nuk pritej;
  - 1.3.22. pagesa të marra nga palë të treta që nuk kanë ndërlidhje;
  - 1.3.23. kontributi i shtuar në një plan pensioni afër datës së daljes në pension.
- 1.4. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut në rastin e sigurimit të jetës të blerë nga korporatat, kur klienti është:
- 1.4.1. bankë ose institucion financiarë që i nënshtrohet kërkesave për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe është i mbikëqyrur për respektimin e këtyre kërkesave;
  - 1.4.2. kompani publike e regjistruar në bursë dhe që i nënshtrohet kërkesave rregulluese për publikim (qoftë me rregullat e shkëmbimit të aksioneve, ose me ligj ose me mjete të zbatueshme) që imponojnë kërkesa për të siguruar transparencë adekuate të pronësisë përfituese, ose një degë me shumicë e një kompanie të tillë;
  - 1.4.3. administratë publike ose ndërmarrje publike.
- 1.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga kanalet e ofrimit të shërbimeve:
- 1.5.1. Shitjet pa prezencë fizike, si shitjet në internet, me postë ose telefon, pa masa mbrojtëse adekuate, siç janë nënshkrimet elektronike ose dokumentet e identifikimit elektronik të përcaktuara me standardet ndërkombëtare.
  - 1.5.2. zinxhiri i gjatë i ndërmjetësve;
  - 1.5.3. ndërmjetësi përdoret në rrethana të pazakonta (p.sh. distanca gjeografike e pashpjegueshme).



- 1.6. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga kanalet e ofrimit të shërbimeve:
  - 1.6.1. Ndërmjetësit janë të njohur për siguruesin, i cili është i bindur që ndërmjetësi zbaton masa të KDK në përpjesëtim me rrezikun që lidhet me marrëdhëniet dhe në përputhje me ato të kërkuara në legjislacionin në fuqi.
  - 1.6.2. Produkti është në dispozicion vetëm për punonjësit e disa kompanive që kanë një kontratë me siguruesin për të siguruar sigurimin e jetës për punonjësit e tyre, për shembull si pjesë e një pakete përfitimesh.
- 1.7. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendet apo gjeografik:
  - 1.7.1. Siguruesi, klienti, pronari përfitues, përfituesi i pronarit përfitues është i themeluar ose kanë lidhje me juridiksione të ndërlidhura me rrezik më të lartë të PP/FT. Siguruesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve pa mbikëqyrjen efektive të PPP/LFT.
  - 1.7.2. Primet paguhen përmes llogarive të mbajtura në institucionet financiare të krijuara në juridiksione të ndërlidhura me rrezik më të lartë të PP/FT. Siguruesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve pa mbikëqyrjen efektive të PPP/LFT.
  - 1.7.3. Ndërmjetësi është i themeluar ose ka lidhje me juridiksione të ndërlidhura me rrezik më të lartë të PP/FT. Siguruesit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë juridiksioneve pa mbikëqyrjen efektive të PPP/LFT.
- 1.8. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga vendet apo gjeografik:
  - 1.8.1. Vendi identifikohet nga burime të besueshme, të tilla si vlerësime të ndërsjella ose raporte të detajuara të vlerësimit, si vend me sistem efektiv të PPP/LFT.
  - 1.8.2. Vendi identifikohet nga burime të besueshme se kanë nivel të ulët të korrupsionit dhe aktivitetit tjetër kriminal.
2. Siguruesit duhet të zbatojnë masat e kujdesit të duhur jo vetëm për klientin dhe pronarin përfitues, por edhe për përfituesit, menjëherë pasi të jenë identifikuar ose caktuar. Kjo nënkupton që subjekti duhet:
  - 2.1. të marrë emrin e përfituesit kur një person fizik ose juridik ose një marrëveshje është identifikuar si përfitues; ose
  - 2.2. të marrë informacion të mjaftueshëm për t'u bindur se identiteti i përfituesve mund të përcaktohet në kohën e pagimit kur përfituesit janë një klasë personash ose të përcaktuara nga karakteristika të caktuara. Për shembull, kur përfituesi janë "nipërit e tij të ardhshëm", siguruesi mund të marrë informacione për fëmijët e mbajtësit të polisës.
3. Subjekti raportues duhet të verifikojnë identitetin e përfituesve më së voni në kohën e pagimit.

4. Kur subjekti raportues e di se sigurimi i jetës i është caktuar një pale të tretë që merr vlerën e polisës, ata duhet të identifikojnë pronarin përfitues në kohën e caktimit.
5. Në situata me rrezik të lartë, masat e mëposhtme të kujdesit të duhur të shtuar mund të jenë të përshtatshme:
  - 5.1. Kur klienti përdor periudhën “free lock”/“cooling-off”, primi duhet të kthehet në llogarinë bankare të klientit nga e cila janë paguar fondet. Siguruesit duhet të sigurojnë që ata kanë verifikuar identitetin e klientit përpara se të bëjnë rimbursim, veçanërisht kur primi është i madh ose rrethanat që shfaqen janë të pazakonta. Siguruesit, gjithashtu duhet të marrin parasysh nëse anulimi krijon dyshime për transaksionin dhe nëse paraqitja e një raporti të aktivitetit të dyshimtë është e përshtatshme.
  - 5.2. Mund të merren hapa shtesë për të forcuar njohuritë e subjektit për klientin, pronarin përfitues, përfituesin ose pronarin përfitues të përfituesit, pagesit dhe paguesit e palës së tretë. Shembujt përfshijnë:
    - 5.2.1. verifikimin e identitetit të palëve të tjera përkatëse, përfshirë paguesit dhe palët e treta të palëve të treta, përpara fillimit të marrëdhënies së biznesit;
    - 5.2.2. marrja e informacionit shtesë për të përcaktuar natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit;
    - 5.2.3. marrja e informacionit shtesë mbi klientin dhe përditësimi më i rregullt i të dhënave të identifikimit të klientit dhe pronarit përfitues;
    - 5.2.4. nëse paguesi është i ndryshëm nga klienti, duhet përcaktuar arsyen pse;
    - 5.2.5. verifikimi i identitetit mbi bazën e më shumë se një burimi të besueshëm dhe të pavarur;
    - 5.2.6. përcaktimi i burimit të pasurisë dhe burimit të fondeve të klientit, për shembull detajet e punësimit dhe pagave, marrëveshjeve të trashëgimisë ose divorcit;
    - 5.2.7. kur është e mundur, duhet identifikuar përfituesin në fillim të marrëdhënies së biznesit, në vend se të prisni derisa të identifikohen ose përcaktohen, duke pasur parasysh që përfituesi mund të ndryshojë gjatë kohëzgjatjes së polisës;
    - 5.2.8. identifikimin dhe verifikimin e identitetit të pronarit përfitues të përfituesit;
    - 5.2.9. duhet marrë masa për të përcaktuar nëse klienti është PEP dhe duhet marrë masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse përfituesi ose pronari përfitues i përfituesit është një PEP në kohën e caktimit, në tërësi ose pjesërisht, të policës ose, më së voni, në kohën e pagimit;
    - 5.2.10. duhet kërkuar që pagesa e parë të kryhet përmes një llogarie në emrin e klientit me një bankë.

*h.*



- 5.3. Kur rreziku i lidhur me një marrëdhënie PEP është i lartë, siguruesit nuk duhet të zbatojnë vetëm masa për KDK, por edhe të informojnë menaxhmentin e lartë para pagimit të policës në mënyrë që menaxhmenti i lartë të mund të ketë një pasqyre të qartë të rrezikut të PP/FT të ndërlidhur me situatën dhe të vendosë për masat më të përshtatshme për të zbutur atë rrezik; Për më tepër, subjekti duhet të kryejnë KDSH përgjatë gjithë marrëdhënies së biznesit. Mund të kërkohet monitorim më i shpeshtë dhe më i detajuar i transaksioneve (përfshirë aty ku është e nevojshme, kërkimi i burimit të fondeve).
6. Në situata me rrezik të ulët, masat e mëposhtme të kujdesit të duhur të thjeshtëzuar mund të jenë të përshtatshme:
- 6.1. Subjekti mund të jetë në gjendje të supozojë se verifikimi i identitetit të klientit është kryer në bazë të një pagesës të bërë në llogari në emrin e klientit me një bankë.
- 6.2. Subjekti mund të supozoj se verifikimi i identitetit të përfituesit të kontratës është kryer në bazë të një pagese të bërë në një llogari në emrin e përfituesit në një institucion të rregulluar financiar.

## Neni 26

### Udhëzime për zyret e këmbimit të valutave

1. Zyrat e këmbimit të valutave duhet të marrin parasysh faktorët dhe masat e mëposhtme të rrezikut krahas atyre të përcaktuara me këtë udhëzim:
- 1.1. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
- 1.1.1. Transaksioni është jashtëzakonisht i madh në terma absolute ose krahasuar me profilin ekonomik të klientit;
- 1.1.2. Transaksioni nuk ka asnjë qëllim të dukshëm ekonomik ose financiar;
- 1.2. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut nga produktet, shërbimet dhe transaksionet:
- 1.2.1. Shuma e këmbyer është e ulët, megjithatë duhet të pasur parasysh se vetëm shumat e ulëta nuk janë të mjaftueshme për të zbritur rrezikun e financimit të terrorizmit.
- 1.3. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga klienti:
- 1.3.1. transaksionet e klientit janë pak më poshtë kufirit të zbatueshëm për zbatimin e masave të kujdesit të duhur, veçanërisht kur ato janë të shpeshta ose brenda një periudhe të shkurtër kohore;
- 1.3.2. klienti nuk mund ose nuk ofron informacion në lidhje me origjinën e fondeve;
- 1.3.3. klienti kërkon të këmbjë sasi të mëdha të valutës së huaj e cila nuk është e konvertueshme ose nuk përdoret shpesh;

- 1.3.4. klienti shkëmben sasi të mëdha kartëmonedhash me prerje të ulët për kartëmonedha me prerje më të lartë në një monedhë tjetër; ose anasjelltas.
- 1.3.5. Sjellja e klientit nuk ka kuptim të dukshëm ekonomik;
- 1.3.6. Klienti viziton shumë ambiente të së njëjtës këmbimore në të njëjtën ditë (në masën që është e njohur nga këmbimorja);
- 1.3.7. Klienti kërkon pyetje në lidhje me prapun e identifikimit dhe/ose refuzon t'u përgjigjet pyetjeve të rastësishme ose rutinë;
- 1.3.8. Klienti konverton fondet e një monedhe të huaj në një monedhë tjetër të huaj;
- 1.3.9. Shkëmbim i shumave të mëdha ose shkëmbime të shpeshta që nuk kanë lidhje me biznesin e klientit;
- 1.3.10. Monedha e shitur nga klienti nuk është në përputhje me shtetin e tij ose të saj të shtetësisë ose vendbanimit;
- 1.3.11. Klienti blen valutë nga një vend i pazakontë në krahasim me vendndodhjen e tij/saj pa ndonjë shpjegim logjik;
- 1.3.12. Klienti blen valutë që nuk përputhet me atë që dihet për vendin e destinacionit të klientit;
- 1.3.13. Klienti blen ose shet një sasi të madhe të një monedhe nga një juridiksion i lidhur me nivele të konsiderueshme të veprave penale kryesore të PP ose veprimtarisë terroriste;
- 1.3.14. Biznesi i klientit është i lidhur me një rrezik më të lartë PP/FT për shembull kazinotë, blerje/shitja e metaleve të çmuara dhe gurëve të çmuar.
- 1.4. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga ofrimi i shërbimeve:
  - 1.4.1. Shërbimi ofrohet tërësisht online pa masa mbrojtëse adekuate;
  - 1.4.2. Ofrimi i shërbimeve kryhet nëpërmjet një rrjeti agjentësh.
- 1.5. Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut nga vendi dhe gjeografik:
  - 1.5.1. Biznesi i zyres së këmbimit ndodhet në një juridiksion të lidhur me rrezik më të lartë të PP/TF;
2. Zyrat e këmbimit të valutave duhet të përcaktojnë qartë në politikat dhe procedurat e tyre të brendshme se në çfarë pike duhet të kryejnë masat e kujdesit të duhur për klientët e tyre të rastit. Kjo duhet të përfshijë:
  - 2.1. Situata kur një transaksion ose transaksione të lidhura të identifikuar arrijnë në 10,000 euro. Politikat dhe procedurat duhet të përcaktojnë qartë se në çfarë pike një seri transaksionesh të njëhershme përbën një marrëdhënie biznesi duke marrë parasysh



kontekstin e aktiviteteve të firmave (d.m.th., madhësia mesatare normale e një transaksioni një herë nga klientela e tyre normale).

- 2.2. Situata ku ka dyshime për pastrim parash apo financim terrorizmi.
3. Zyrat e këmbimit të valutave gjithashtu duhet të vendosin sisteme dhe kontrolle për:
  - 3.1. identifikimin e transaksioneve të lidhura (për shembull, për të zbuluar nëse i njëjti klient i drejtohet zyrave të shumta në një hapësirë të shkurtër kohe); të monitorojë transaksionet në një mënyrë që është e përshtatshme dhe efektive në proporcion me madhësinë e zyrë, numrit të zyrave të saj, madhësisë dhe vëllimit të transaksioneve;
  - 3.2. llojin e aktiviteteve të kryera, kanalet e ofrimit të tij dhe rreziqet e identifikuara në vlerësimin e rrezikut në mbarë biznesin.
4. Në situatat ku rrezik nga PP/FT është i lartë, zyret e këmbimit duhet të aplikojnë masa të kujdesit të duhur të shtuar në pajtueshmëri me këtë udhëzues, duke përfshirë ku është e nevojshme rritje e monitorimit të transaksioneve si dhe marrja e më shumë informacioneve në lidhje me natyrën dhe qëllimin e biznesit, ose burimin e fondeve të klientit.
5. Në situatat ku rreziku nga PP/FT është i ulët, zyrat e këmbimit mund ta konsiderojnë zbatimin e masave të kujdesit të duhur të thjeshtëzuar siç mund të jenë:
  - 5.1. shtyrja e verifikimit të identitetit të klientit për një datë të caktuar të mëvonshme pas krijimit të marrëdhënies.
  - 5.2. verifikimi i identitetit të klientit në bazë të një pagese të tërhequr në një llogari në emër të vetëm ose të përbashkët të klientit në një institucion bankar.

#### **Neni 27**

#### **Dispozitat kalimtare**

Institucionet financiare kanë afat për t'u përgatitur për zbatueshmërinë e dispozitave të këtij Udhëzuesi deri më 1 shkurt 2024.

#### **Neni 28**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzues hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Ahmet Ismaili

Kryesues Bordit Ekzekutiv